

Sesioni Informues mbi Reformën Administrative-Territoriale 2026

05 maj, 2026.

Vlore, Shqiperi

Minutat e Takimit

Valbona Karakaci:

Përshëndetje të gjithëve, mirë se erdhët në dëgjesën e katërt publike të Komisionit të Përbashkët për Reformën Administrative Territoriale. Këto dëgjesa publike janë në shprehje të nismës së këtij komisioni për të sjellë më afër politikëbërjes zërin e qytetarëve, botës akademike, ekspertëve, biznesit, por edhe aktorëve dhe faktorëve të angazhuar në jetën politike. Për të vendosur kuadrin e përgjithshëm të kësaj dëgjese më lejoni t'ia kaloj fjalën dy bashkëdrejtuesve të komisionit, z. Mazniku dhe z. Boçi.

Arbjan Mazniku:

Të nderuar kryetarë të Bashkisë së Qarkut të Vlorës, të nderuar deputetë, të nderuar akademikë, miq të tjerë të Vlorës, është kënaqësi që jemi sot në dëgjesën e katërt të turit të dëgjese të komisionit për një ndër reformat më të rëndësishme që vendi ka përpara, që është reforma e administrative territoriale. Kur një shqiptar mesatar mendon tipikisht për shtetin dhe për ndërveprimin me shtetin, në shumicën e rasteve, në fakt, po të pyesim një njeri të thjeshtë, mendon për ndërveprimin që ai ka me Bashkinë. Pasi që në momentin që ne lindim, kur dalim nga materniteti, ke çerdhja, kopshti, kur hidhen mbetjet, ke derën e shtëpisë, kur hapet çesma për t'u larë, kur luan një fëmijë jashtë, kur lëviz me transport publik, kur shkon në shkollë, kur shkon në gjimnaz, kur martohet dhe ka nevojë për një shtëpi, e kështu me radhë, kur shkon një moshë të caktuar, po deri në momentin e fundit madje, kur një njeri e përcjell në botën tjetër, e ka jetën të lidhur një mënyrë ose një tjetër me Bashkinë, me punët e Bashkisë. Ndaj dhe kur ne i themi njerëzve se si punon shteti, si funksionon shteti, një pjesë e madhe e njerëzve, në shumicën e rasteve, mendojnë se si funksionon institucioni që kanë afër. Për shumë njerëz, fytyra e shtetit është Bashkia. Ndaj dhe funksionimi siç duhet dhe pasja e mundësisë që Bashkitë, institucionet vendore, të jenë funksionale, të jenë të përgjithshme, t'i kenë kapacitetet e duhura për t'iu përgjigjur njerëzve, është një ndër ato reforma e cila e prek në mënyrë të përditshme jetën e çdo njeriu. Ndaj dhe është krejt normale që ne të jemi të gjithë sensitivë ndaj një reforme të tillë, por ndaj dhe kjo merr dhe një rëndësi të caktuar, merr një vëmendje të caktuar, merr një debat të caktuar. Ne jemi përpara një reforme e cila bëhet pas 10 vjetësh, pasi një reformë tjetër, e cila është drejtuar nga miku ynë Çuçi që është këtu sot në sallë, e cila është padyshim, në mendimin tim, një ndër reformat më të rëndësishme që Shqipëria ka bërë dhe nga ato më efektivet. Pasi ne kaluam nga një situatë ku kishim 373 bashki dhe komuna të fragmentizuara, të cilat nuk kishin asnjë mundësi për të ofruar në mënyrë të prekshme shërbimet e përditshme të pastrimit, të infrastrukturës, të mirëmbajtjes së shkollave, kopshteve, të furnizimit me ujë e të gjitha me radhë, në 61 bashki, të cilat janë padyshim

shumë herë më të afta për të ofruar shërbimet që duhet të ofrojnë. Të gjitha të dhënat na tregojnë që në fakt kemi një situatë të përmirësuar në raport me atë që ka qenë para 10 vjetësh. Buxhetet e Bashkive janë rritur, të ardhurat e veta janë rritur, shpenzimet për investime publike janë rritur, borxhi që Bashkitë kanë ndaj palëve të treta ka rënë në mënyrë masive. Nëse Bashkitë dikur shpenzonin rreth 72% të buxhetit të tyre për paga dhe sigurime, sot pagojnë rreth 43% në buxhetin e vitit 2025, vitit të fundit që mbyllëm. Kjo do të thotë që nga shumë parametra Bashkitë janë përmirësuar. Por sërish situata nuk është e njëtrajtshme. Ne kemi Bashki të cilat funksionojnë shumë mirë, Bashki të cilat kanë të ardhura të qëndrueshme të vetat, Bashki që nuk kanë të ardhura të qëndrueshme. Kemi Bashki të cilat stafin për 1000 banorë e kanë 25, kemi Bashki të cilat stafin për 1000 banorë e kanë 7. Kjo do të thotë se diferencat në sa njerëz për një banor kanë, janë shumë të mëdha. Diferenca e shërbimeve, cilësisë së shërbimeve është shumë e madhe. Diferenca e varësisë nga granti i qeverisë është shumë e madhe. Dhe është një moment që ne të shohim si mund t'i bëjmë Bashkitë më efikase, si mund t'i bëjmë më efektive, si mund të sigurojmë që Bashkitë t'i kenë mundësitë dhe kapacitetet për t'i ofruar shërbimet që duhet t'i ofrojnë njerëzve, në cilësinë që duhet. Në fushatën e reformave të 2014-ës gjithashtu ishte një reformë shumë decentralizuese. Sot Bashkitë kanë 42 funksione në ligj, pothuajse 20 prej tyre kanë qenë funksione të reja që nuk i kanë pasur më parë, të cilat iu deleguan Bashkive në vitin 2014. Çështja është: a i kanë kapacitetet financiare për t'i ushtruar këto funksione? A i kanë hapësirën ligjore për t'i ushtruar siç duhet këto funksione? A e kanë mundësinë për të gjeneruar më shumë të ardhura që t'i zbatojnë siç duhet këto funksione? Ndaj dhe shumë e rëndësishme, dhe kjo është kërkesa ime e parë për të gjithë dëgjesen e sotme, është që të diskutojmë më së shumti për mënyrën se si Bashkitë i ushtrojnë funksionet e tyre dhe si i kanë mundësitë, qofshin këto mundësi ligjore, qofshin këto mundësi financiare, qofshin këto mundësi administrative nga pikëvështrimi i njerëzve për t'i ofruar shërbimet. A kanë mjaftueshëm arkitektë, inxhinierë, juristë? A i kanë burimet e nevojshme njerëzore për ta zbatuar siç duhet funksionin që kanë? Dhe më pas, padyshim, të flasim për territorin, por të mos rrëshqasim te diskutimi i territorit, sepse aty e di që në të gjithë Shqipërinë, këtu në Vlorë pak edhe më shumë, që ndizen pasionet e territorit, pasionet e lokalitetit, pasionet e një zone të caktuar, ku padyshim, kur ne të diskutojmë për një reformë administrative territoriale, duhet të marrim parasysh dhe ndjeshmëritë e territorit, duhet të marrim parasysh edhe historinë, edhe kulturën, edhe ndjesinë e një komuniteti që ndihet si i tërë. Dhe padyshim ky duhet të jetë një faktor kryesor diskutimi, por nuk duhet të jetë i vetmi faktor determinues, pasi një ndër problemet që unë besoj që neve jo rrallëherë kemi, ka të bëjë me çuarjen e një funksioni në një vend në të cilin nuk ushtrohet dot. Dhe një funksion i cili shkon në një njësi ku nuk ushtrohet dot, është një funksion që është më mirë të mos jetë, sepse është në letër, por në praktikë qytetari nuk e merr shërbimin që lidhet me atë funksion. Ndaj dhe është shumë e rëndësishme që ne të diskutojmë ku është pika prerëse midis ofrimit të shërbimit ndaj njerëzve dhe mundësisë praktike të prekshme që pastrimi të bëhet, shkollat të mirëmbahen, tregu i qytetit të funksionojë, që zonat e gjelbra të funksionojnë, që kanalet kulluese e vadicës të mirëmbahen, që furnizimi me ujë të bëhet, që largimi i ujërave të shiut të bëhet, që të fuqizohet dhe ekonomia lokale dhe që Bashkia të fillojë të mendojë dhe si një strukturë

që nxit zhvillimin ekonomik të territorit të saj. Ndaj dhe nëse mendojmë në këtë strukturë, besoj se mund të ecim në rrugë të mbarë për të bërë një reformë e cila të impaktojë jo thjesht dy vitet e ardhshme, jo thjesht katërvjeçarin e ardhshëm, por të impaktojë mënyrën se si Shqipëria zhvillohet në 20, 30 apo 40 vitet e ardhshme. Ne jemi dhe një pikë kyçe, është e rëndësishme ta bëjmë këtë diskutim dhe të jemi shumë transparentë me njëri-tjetrin për këtë situatë. Jemi sot që flasim, jemi pothuajse një vit larg zgjedhjeve të radhës vendore dhe ky është një moment shumë i rëndësishëm, pasi ne kemi mundësi të bëjmë bashkërisht një reformë administrative territoriale përpara zgjedhjeve të 2017-s dhe në atë moment zgjedhjet e 2017-s Bashkitë futen në këtë para 2027-s, keni të drejtë, me një sistem të ri, me kompetenca të reja, me mënyra të reja, me mundësi të reja financiare dhe ta përdorin hapësirën 2027-2030 si një moment përgatitjeje edhe nga ana e pushtetit vendor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Në vitin 2027 ne mbyllim negociatat me BE, sot Parlamenti Evropian ka nxjerrë një rezolutë në të cilën thotë që është një objektiv i arritshëm mbyllja e negociatave në 2027-n dhe eventualisht në 2029-n janë të gjitha shanset që Shqipëria të bëhet një vendantare. Në atë rast, në qoftë se ne ia dalim të bëhemi dhe bëjmë të gjithë detyrat e shtëpisë siç duhet, në 2029-n të jemi vendantare, Shqipëria e ka të gjitha mundësitë që të përfitojë nga dy nga programet kryesore të zhvillimit që BE-ja ka: Programi i Fondit të Kohezionit Social dhe Fondit Strukturor. Të dyja këto programe kërkojnë që ne të kemi Bashki të forta, të afta për të bërë projekte dhe programe që mund të tërheqin nga BE investime për zhvillimin e territorit, por kjo kërkon sërisht Bashki që të mendojnë në këto terma dhe ky dritare, arritja që ta përmbysim reformën brenda këtij viti, në 2027-n të hyjmë me sistemin e ri në zgjedhje dhe të përdorim 27-31-shin si një moment përgatitjeje, në mënyrë që kur Shqipëria të jetë një vendantare në BE në 2030-n dhe me ciklin e ri programor, Bashkitë tona të jenë të afta, dhe jo vetëm Bashkitë, por edhe Bashkitë e rajonit, të tërheqin fondet që duhet të tërheqin nga BE për t'i dhënë një zhvillim territorit tonë. Ndaj dhe jemi në një moment i cili lidh jo vetëm rëndësinë që ka reforma, por edhe momentin në të cilin Shqipëria po ecën për ta kryer këtë reformë siç duhet. Fjalja e fundit që dua të them është që sot raporti i Komisionit Evropian, i më falni, raporti i Parlamentit Evropian, rezoluta, ka një paragraf të posaçëm për punën e reformës, unë po e citoj, meqenëse besoj se ishte një lajm i mirë për të gjithë palët, thuhet: "Parlamenti mirëpret punën në vijim të Komisionit Parlamentar Ndërpartiak për Reformën e Socialit Territoriale, duke theksuar se çdo reformë në këtë fushë duhet të zhvillohet përmes një procesi të tillë, gjithëpërfshirës, të mbështetur në kritere objektive sociale-ekonomike dhe në përputhje me standardet evropiane të vetëqeverisjes vendore." Dhe besoj se kjo përmendje, por edhe ky proces i cili është duke u bërë me dëgjese të gjithë palëve dhe mundësinë e çdo personi që të thotë fjalën e tij, mendimin e tij, është një mekanizëm i mirë për të krijuar një zgjidhje dhe një sistem i cili t'i qëndrojë kohës dhe t'i zgjidhi problemet e përditshme të qytetarëve. Faleminderit shumë.

Luciano Boci:

Të dashur qytetarë të Vlorës, nderuar deputetë, drejtues të pushtetit vendor, mirë se ju gjejmë. Sot kemi dëgjuesen e katërt pas Lezhës, pas Elbasanit. Dhe sigurisht Gjirokastra ishte ajo që e sikur e ndezi situatën dhe patjetër që Vlora ka specifikën e vetë, sepse

thënia e të vërtetave me zë të lartë në Vlorë është pjesë e shpirtit vlonjat dhe unë dua ta nis nga një e vërtetë që është edhe përtej Vlorës, që është edhe kombëtare, por rezultoi që qenka dhe ndërkombëtare. Ajo përshëndetja që i bëhet punës së Komisionit dhe faktit që ne realizojmë dëgjesa me komunitetet, që jemi në një qëllimësi të përbashkët, është gjë shumë e mirë në fakt, por nuk duhet të mbetet thjesht në lavdërimin e një procesi. Ajo që ne kemi kërkuar si përfaqësues politikë të Partisë Demokratike, që e kam insistuar që ditën e parë, që vazhdoj ta insistoj, ka të bëjë pikërisht me vazhdimësinë e atij paragrafi, që Komisioni i Reformës Territoriale duhet të ketë patjetër një konkludim konsensual, të dakordësuar nga Partia Demokratike, nga opozita, se ka edhe forca të tjera politike dhe nga maxhoranca. Përndryshe, të gjithë këto lavde, të gjithë këto dëgjesa, i gjithë investimi i bërë përgjatë kësaj kohe nuk do të vlente fare dhe kjo dëgjese shërben shumë, shumë më shumë se çdo gjë tjetër, shërben më shumë se dhe bisedat e mbyllura në salla apo vendimet e marra në salla. Prandaj duhen dëgjesat dhe jo thjesht dëgjesa për të bërë denoncime, jo thjesht për të bërë lavdërime administrative që vijnë nga njerëz administrativë, por edhe për të sjellë këtu propozime shumë të rëndësishme, konkludime që vijnë nga zëri bruto, nga zëri i qytetarëve. Dhe dëgjesat patjetër janë të rëndësishme, sepse për të kuptuar gjërat për një reformë territoriale, territori nuk lexohet në Parlament, nuk lexohet thjesht në Komision, territori lexohet këtu, në dëgjesat publike, lexohet në rrugët e braktisura, në fshatrat, në lagjet e Vlorës, në mungesën e shërbimeve dhe në problemet e mëdha që ka qarku i Vlorës, që ka Saranda, që ka Urikumi, që ka Kota, që ka Selënica dhe gjithë hapësira e madhe e këtij qarku, që është një nga qarqet kryesore dhe me peshë në Shqipëri, sepse zë gati 10% të sipërfaqes së Shqipërisë dhe gati 6% të popullsisë së Shqipërisë sipas censusit të fundit. Po, dëgjesat janë të domosdoshme, sepse reformat nuk janë pronë thjesht e politikës, reformat janë ato që sjellin pasojë të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit. Po, jam dakord që pushteti vendor ndikon në çdo stad të jetës tonë, në çdo hap të jetës sonë, madje ai përcakton pse jo edhe nivelin e lumturisë dhe dashurisë që ne kemi me vendin, me territorin, me lagjen, me shtëpinë dhe me gjithçka tjetër në rrethon. Prandaj dhe kjo reformë ka një rëndësi shumë të madhe dhe shumë specifike. Por ama duhet të jemi shumë të saktë pse kemi ardhur në këtë reformë pas 10 vitesh, sepse duket sikur ne jetojmë në regjim reformash. Na është bërë kjo fjala reformë, nuk e di, fjala më konsumuar dhe këto reformat nuk kanë as stade më, nuk kuptohet dhe duhet të jemi shumë të qartë që këtu nuk jemi për të krahasuar 2014-n, 2015-tën me para 2014-s dhe 2015-s, sepse ky këndvështrim është tërësisht i padrejtë për mua, se do të thoja i gabuar, por e kurseva fjalën i gabuar. Ne duhet ta bëjmë krahasimin me atë çka u parashikua 2014-15-tën dhe atë që solli 2014-15-a. Këtu është esenca e parashtrimeve tona dhe e qëndrimeve tona dhe në një pyetje shumë të thjeshtë, pyetja që sundon edhe në këtë sallë dhe jashtë kësaj salle është: A dështoi reforma e 2014-s? Dhe në fakt, përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje përcakton edhe mënyrën si menaxhohet dëgjesa jonë, mënyrën si do eci Komisioni dhe mënyrën si do konkludojë vetë në fund fare Komisioni i Reformës. Por për të bërë këtë, për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, unë kam një pyetje tjetër shumë më të thjeshtë: A është më mirë jeta e qytetarit para kësaj reforme apo pas kësaj reforme? Sot si është? Dhe joja është taksative dhe tregon qartazi gjendjen në të cilën ndodhet sot pushteti real vendor në Shqipëri, përtej lavdërimeve. Prandaj nuk na

duhen lavdërime administrative fare, unë s'jam për këtë, ne na duhet sinqeritet dhe guxim për të ndërmarrë ato masa që vërtetë i shërbejnë qytetarit dhe i shërbejnë pushtetit vendor, sepse tek e fundit këtu na ka sjellë shqetësimi qytetar, nuk na ka sjellë e mira që solli 2014-a dhe këtë të mirën me hipokrizi hajde ta bëjmë shumë të mirë, se na kanë dalë ca defekte të vogla, jo, sepse përndryshe kjo reformë do të ishte e kërkuar nga kryetarët e Bashkive, nuk e kanë bërë një gjë të tillë, do kërkonin më shumë funksione, më shumë kompetenca, jo, nuk e kanë bërë në fakt, sepse dhe ato i kanë duar dhe lidhura, kanë shumë ndërhyrje nga pushteti qendror, por dihet, mënyra e menaxhimit politik në Shqipëri gjithmonë ndikon dhe në artikulet dhe qëndrimet politike dhe këtu nuk na ka sjellë as kërkesa e Bashkimit Evropian, po, Shqipëria aspirojnë të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, është një rrugëtim ku kontributi nuk është i një force politike, ajo që ngre kupën, jo, është i të gjithë forcave politike që nga '90-ta në Shqipëri dhe i gjithë qytetarëve shqiptarë dhe tek ata vërtetë ka një shqetësim për demokracinë vendore, për autonominë e pushtetit vendor në Shqipëri, për shërbimet, për përfaqësimin dhe nuk kanë vendosur kushte që patjetër duhet të realizohet një model i caktuar me qëllim që nëpërmjet këtij modeli të arrihet edhe marrja e fondeve nga fondet e kohezionit apo strukturore. Sot Kroacia, që ka njësi shumë të vogla, 556, ka marrë miliarda me ato bashkitë e veta të vogla, po kështu Polonia, po kështu Sllovenia, po kështu Estonia dhe nuk është fare pengesë që ne duhet patjetër të reduktojmë numrin e bashkive, që të jemi të suksesshëm në atë hapjen e portës së Bashkimit Evropian. Dhe ku e shohim ne dështimin, ku e prekim? Po, e prekim kudo, sidomos këtu në Vlorë, Vlorë është specifike, jo më kot në fillim thashë që kemi bërë Gjirokastrën dhe Elbasanin dhe në fillim ishte Lezha. Në qoftë se Gjirokastra ishte ndarja më ideale përse i përket numrit të banorëve, është në përputhje me mesataren e Bashkimit Evropian, gati 6000 banorë dhe problemet më të mëdha i përkisnin funksionalitetit, kompetencave, përfaqësimit, shërbimit që janë kudo, Elbasani ishte krejt ndryshe, ka njësi shumë të mëdha dhe problemi i territorit atje është shumë i madh dhe i banorëve është shumë i madh, sigurisht bashkangjitur dhe problemet e tjera dhe Vlorë është një lloj miksimi, është rasti më tipik i dështimit të reformës territoriale, nuk e thotë Partia Demokratike, nuk e thotë vetëm opozita, e thotë raporti i Bankës Botërore i vitit 2024, ku i referohet dy bashkive të qarkut të Vlorës, Bashkisë së Vlorës dhe Bashkisë së Selënicës dhe e përcakton qartazi që janë shembujt e dështimit të reformës territoriale të 2014-15-s, sepse masia e bashkive nuk rriti qytetarin, e zvogëloi qytetarin, sepse rritja e territorit të bashkive uli numrin e shërbimeve ndaj qytetarit, sepse uli dhe cilësinë e shërbimeve. Ne sot vuajmë një diskriminim edhe këtu në qarkun e Vlorës midis vetë bashkive, sepse ka bashki që kanë kapacitete financiare, realizojnë të ardhurat e tyre, kanë mbështetje qeveritare, kanë investime, ka edhe bashki që nuk i marrin dot, mezi i shtyjnë muajin, mezi i nxjerrin pagat dhe kjo është e vërteta, por diskriminimi nuk mbaron këtu, diskriminimi është brenda një bashkie, zonat rurale ndryshojnë nga zonat urbane, zonat urbane janë më të shërbyera dhe akoma më tej brenda vetë zonës urbane, këtu në Vlorë sidomos, kemi një diferencë shumë të madhe midis shërbimeve në lagje të caktuara. Duhet ta dimë shumë mirë që Vlorë nuk është 3 km lungomare, të paktën nga dhënat dhe të gjitha këto që unë po artikuloj nuk janë të miat, janë konkluzione që dalin nga raporti i Bankës Botërore, sepse ky është realiteti dhe se jemi në trysinë e kohës

dhe dëshira për të folur ndonjëherë është e madhe dhe mbi të gjitha ajo që shmanget dhe në fakt që dihet nga të gjithë që duhet të artikullohet është që reforma e 2014-15-s, u nis si administrative dhe përfundoi politike, vijat e hartave u vendosën sipas numrit të votave, sepse ajo që ndodh këtu në Shqipëri është sui generis, pushteti lokal konsiderohet si magazinë botash e pushtetit qendror dhe anasjelltas, pushteti qendror është faktori kryesor i kapjes dhe i fitimit të pushtetit lokal dhe është kjo varësi politike që prevalon dhe ajo reformë përkufizohet shumë saktë, ajo ishte reformë e pushtetit, nuk ishte reformë për qytetarin, qytetari ishte sekondar. Prandaj sot kemi më pak kompetenca, më pak funksione, më pak shërbime, më pak shërbime cilësore, kemi më pak demokraci, më pak autonomi financiare, kemi më shumë centralizim, më shumë varësi nga qendra, më shumë punësime fiktive, pavarësisht 43% që luhet me ato shifrat, zakonisht kur vjen përqindjet ta dini që loja është shumë e madhe, sepse punësimet këtu janë dyfishuar, janë trefishuar, ndërkohë që alarmet janë që s'ka kapacitete administrative dhe vendet e punës janë shtuar dhe ka më shumë, ndërkohë më shumë abuzim, më shumë centralizim dhe më shumë abuzim, 43 kryetarë dhe ish-kryetarë sot janë në dyert e SPAK-ut, gjë që tregon që ka një dalje negative nga mënyra si është lënë administrimi i pushtetit, pikërisht të pushtetit vendor apo drejtuesve. Duam zgjidhje? Po, patjetër, sigurisht po doja shumë e qartë në qëndrimin e saj, funksionalitet, dhënie e kompetencash dhe shtim shërbimesh, funksione të përcaktuara, duke përcaktuar mjetet financiare që do ketë një bashki, mbështetje nga buxheti i shtetit dhe patjetër ne s'mund të heqim dorë nga territori, territori është kryesor. Orikumi thotë dhe raporti i Bankës Botërore duhet të jetë mbete, pse mos jetë mbete si bashki, pse është hequr? Për shembull, pjesa e Mifolit, po dhe ajo bashki mbete, pjesa e Kodhës dhe ajo bashki mbete, sepse duhet të afrohet qytetari me shërbimin, Bashkimi Evropian e ka 60 minuta larg në minutazh dhe patjetër ne duhet t'i kthejmë shërbimin, do flasim për funksionet, për shërbimet, për të gjitha jemi dakord dhe me nivele tjera të pushtetit vendor që marrin kompetenca dhe përthithin fondet, por patjetër që do flasim dhe për territorin, sepse territori nuk është në qëllim vetvete, por është mjeti kryesor për të zgjidhur qëllimin që ka reforma territoriale për t'i shërbyer qytetarit. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Mirë, unë kam detyrën e vështirë, mbase shihni një ekran aty. 3 minuta më shumë se zoti Mazniko, 3 minuta më shumë në fund. Gjithsesi. Pikërisht sepse unë kam marrë nga miqtë e mi vlonjat një këshillë: kujdes në Vlorë, duhet të jesh shumë korrekt dhe shkëmbeva dhe disa vështrime në sallë. Tani momenti është në fakt për zërin tuaj, zërin kryesisht të qytetarëve, këto dëgjesa kanë ardhur me aspiratën për të dëgjuar më shumë se për të folur politika, më lejoni që të ndaj disa rregulla pa filluar në mënyrë që të respektojmë njëri-tjetrin. Dëgjesa është e strukturuar në tre komponentë kryesor, duke mirëkuptuar që ato nuk funksionojnë të izoluar njëra nga tjetra, por sidoqoftë këto janë edhe tre dimensionet e analitike përmes të cilave është organizuar puna e Komisionit. Në sesionin e parë do të fokusohemi te aspektet që lidhen me territorin dhe qeverisjen, në sesionin e dytë me funksionet, kompetencat, shërbimet dhe në sesionin e tretë me financat vendore. Secili prej këtyre sesioneve do të zgjasë rreth 30 minuta, gjë që nëse respektojmë kohën 2 deri në 3 minuta për çdo ndërhyrje, do kemi mundësi që të

dëgjojmë rreth 10-11 ndërhyrje në secilën prej sesioneve. Do t'ju lutesha që të jeni koncizë në ndërhyrjet tuaja, veçanërisht të jepni mundësi Komisionit të dëgjojë rekomandime që lidhen me të ardhmen, sepse politikbërja për të cilën jemi mbledhur sot do duhet të adresojë përmirësime që i përkasin të ardhmes. Janë 7 njësi vendore në qarkun e Vlorës, sërish do kërkoja mirëkuptimin tuaj në mënyrë që të kemi zëra nga 7 bashki të mundësisht që të ketë ndërhyrje. Zonjat, unë kam për detyrë që t'i dëgjojmë zërin e tyre gjithashtu dhe do t'ju lutesha që të mbani parasysh që ky sesion transmetohet drejtpërsëdrejti në kanalën e dedikuar të Televizionit Publik Shqiptar në kanalën e Kuvendit, por njëkohësisht do të keni mundësi që ta ndiqni të regjistruar, përveçse të regjistruar edhe një përmbledhje të tij, mund ta aksesoni në web-in e dedikuar në faqen e Parlamentit. Këto janë pak a shumë rregullat e lojës. Nëse shoqëritë civile të këtij orizont do flasin. Atëherë do dëgjojmë zërin e shoqërisë civile, ju lutem nëse mund të prezantoheni edhe nga vini në mënyrë që të sigurojmë një balancë menjëherë mbrapa, zotëria.

Ilia Bombaj:

Quhem Ilia Bombaj, vij nga Selënica e Vlorës, përfaqësues i shoqërisë civile. Ka nisur, me të vërtetë kjo reformë ka hedhur një hap shumë pozitiv. Unë do t'ju argumentoj pse, sepse ju keni mundur të sillni këtu në këtë sallë tre aktorët kryesorë, përfaqësues të dy forcave të mëdha ose të dy kampeve dhe aktorin e tretë, shoqërinë civile, këshilltarët dhe kryetarët e bashkive. Ky është një hap shumë pozitiv. Me shumë vëmendje dëgjova të dy bashkëkryetarët, u përpoqa që të mos të fusin bindje politike në këtë dhe u them: "Lumë si ju në qoftë se nuk do të ndiqni këtë, largohuni nga politika dhe i sillni këtij populli të shumëvujtur një reformë të mirë administrative." Nuk ka të bëjë numri plus apo minus se sa dhënia e kompetencave bashkive. Bashkitë duhet të kenë kompetenca. Shkoni, ja ku e kemi Kosovën, një shtet i ri është? Kanë kompetenca kryetarët e ato pushteteve vendore sa s'ka ku të vejë më? Mos shkoni drejt centralizimit, boll kemi vuajtur me këto centralizime. Jepini vendit decentralizim, i jepni kompetencë, mos i mund të vijë ai nga ana nga Tepelena në qendër të Selënicës, nga Imana në qendër të Selënicës, nga Mallakasra në qendër të Selënicës. Ju lutem shumë, ju lutem shumë, më fal, ju lutem shumë, Selënica është një qytet ku Plini i Straboni, Aristoteli, kanë folur prej para Krishtit se cili është ai qytet, para se të bëhesh Vlora, e shumë qytete të tjera të Shqipërisë. Ka patur klasën e parë punëtore në Shqipëri e cila e ndjeu shtypjen nga pushtuesi nazifashist. Është një bashki e cila ka resurse jashtëzakonisht të mëdha, ka naftën, ka serrën, mineralin e rrallë në botë, jo në Ballkan as në Europë, por në botë. Ka resurse plot, po varet sa kompetenca i ka dhënë shtetit kësaj bashkie apo këtij komuniteti. Renta minerare shumë e keq, shumë e ulët, përse mos t'i shkojë bashkisë kjo e ardhur? Që investimi të shkojë tek qytetari dhe kryetari i bashkisë të ketë kompetenca të plota, ta diku ta hedhë investimin, jo atje ku është një dhijë edhe një njeri, por atje ku është produktive, ku është populli. Ne rendim atje ku nuk ka asnjë lloj produktiviteti, ky shërbim, për çfarë e japim? Jemi rendur, po bëjmë shkolla në çdo cep si kërpudha, bashkohemi me shkollat se i ka bota kështu, çohu ato buzë, çohu shërbime, të vijnë shkollat atje ku duhen, në një vend, ama di që i kemi nxënësit dhe përgjigjemi për nxënësit. Përse i bëjmë këto shkolla? Po flenë gomejtë, po flenë bagetitë, i shikoni,

kontrolloni në çdo cep të Shqipërisë. Ju lutem, bëni një gjë për këtë popull të mirë, bëni, bashkohuni, i lini politikat. Faleminderit.

Ju faleminderit. Ju faleminderit. Zotëria dhe pastaj zoti Malaj, po. Ju lutem, po. Nëse mund të prezantoheni. Do vlerësoja nëse fokusohemi tek çështjet e territorit dhe qeverisjes.

Skerdian Dhuli:

Përshëndetje. Do të jem shumë telegrafik. Faleminderit. Përshëndetje, Skerdian Dhuli, në profesion jurist, nga Bashkia e Himarës. I dëgjova dy zotërinjtë, për të mos marrë kohë tjetër më pas duke u referuar të trija pikave tuaja, do të jem konciz për tri aspekte. Reforma e 2014-s, fakti që ne jemi këtu sot, tregon që dështojë. Pse? Dështojë në tri aspekte: financiar, territorial dhe në kompetenca. Tani po i rikthehem te kompetencat. Unë votoj për këshillat bashkiake dhe këshilli bashkiak është organ kolegjal legjitim sepse del nga vota, ndërkohë që vazhdimisht i bjerin kompetencat. Kryetarët e bashkive në gjithë Shqipërinë sot ngjajnë si drejtorë komunalesh ose drejtorë shërbimesh, t'ju vendosim një emër pak më të bukur. Erdhi momenti që ju morën dhe ujësjellësat. Bashkia e Himarës administron 70% të detit tonë, po ndërkohë lejen e plazhit duhet ta marrësh te ministria. Na thuhet që ne duhet të marrim paketën e maleve. Unë e kam origjinën në një fshat ku malet e atij fshati i administron Bashkia e Delvinës. Pra tokën e gjyshit tim sot e administron Bashkia e Delvinës. Më fal, por në cilën bashki duhet të shkoj unë të aplikoj të trokas? S'mendoj që do ma mbyllin derën asnjëherë, apo mund të më thoni: "Ju lutem, fshati sot është i Bashkisë së Himarës, fshati dje, i para 70 vjetësh, tokat e gjyshit tim i përkasin Bashkisë së Delvinës." A ka logjikë kjo? Shkojmë pak tek territori. Dhe më fal, prapë te kompetencat. Tani unë dokumentat e makinës time duhet t'i kryej në Sarandë, ndërsa pa pasaportën duhet të ta marr te komisariati në Vlorë, nga shtëpia ime në Vlorë. Më fal, nga shtëpia ime aty në fshat. Komisariati në Vlorë është 93 km. A mund të më thoni një shtet europian ku mundet të shkosh për një shërbim 93 km larg? A mund të më thoni që fshati i fundit i Bashkisë së Himarës ka sot qendrën e bashkisë 60 km? Hajde ma gjeni një rast të dytë. Prandaj do shkojmë dhe tek rivizatimi i bashkive. Ky qark ka problematika të theksuara edhe të natyrës tjetër. Ka një shtrirje prej 170 km është në rrugë, pra nga Aurë Mifoli, në Konispol është 170 km, zonjë e nderuar, dhe po ju drejtohem juve, që do të thotë po sikur ta mendojmë dhe idenë që ky qark të ndryshojë hartën rajonale, se nga Konispoli në Vlorë është 140 km, 170 km sot. A ka logjikë kjo? A mund të quhet funksional një rajon i tillë? Tjetra, pse duhet që unë si qytetar të paguaj taksa për një institucion që quhet prefekturë, kur s'ka asnjë kompetencë, s'ka asgjë në dorë, s'e pyet kush për asgjë? A mund të më thoni pse duhet të qëndrojmë këtu? Ose i shtojmë kompetencat dhe unë jam për këtë pjesë, t'i shtojmë kompetencat, ose ta shkrijmë. Për çfarë duhet ta kem? Për çfarë duhet ta paguaj? Pra, kompetencat ju duhen shtuar. Nuk mundet që ujësjellësin, kur para tre vjetësh, kur është votuar Bashkia e Vlorës, ujësjellësi ka dhënë llogari, Bashkia është votuar dhe për pjesën e ujësjellësit. Sot kam dalë nga shtëpia për të ardhur këtu, s'kisha unë shtëpi. Po kujt t'i kërkoj llogari? Se ujësjellësin e ka marrë qeveria, ndërkohë që para tre vjetësh, kur është votuar, Bashkia është votuar dhe për këtë shërbim. Pra, vazhdimisht pushtetit lokal, e përfundova, i bjerin kompetencat, ndërkohë edhe pjesa e hartës. Unë jam

partizan i bashkive rurale dhe bashkive urbane, sepse kryetari i bashkisë i qytetit nuk e ka në refene, kurrresi, pjesën e fshatrave. Vlora është një shembull, po nëse doni unë nxjerrëm gjithë Shqipërinë për shkak të eksperiencës time, mund ta marr shumë lehtë në gjithë Shqipërinë. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Po, zoti Malaj, zoti Malaj, e ka kërkuar fillimisht zoti Malaj. Ju lutem.

Arben Malaj:

Përshëndetje dhe faleminderit. Së pari, faleminderit qytetarëve edhe komisionit, po mos na lajmëroni një ditë përpara, se ne nuk jemi pica taksi. Që të përgatitemi, duam kohë. Ajo që do të thosha që në fillim debati është për demokracinë dhe në qoftë se flitet për decentralizim, flitet për demokracinë dhe demokracia lokale përcaktohet si gjaku i demokracisë në nivel vendor, sepse sa më afër të jemi me reformat që bëjmë me qytetarin, aq më i vogël është deficieti demokratik. Kështu që reforma juaj në vitin 2014 e ka çënuar rëndë këtë parim të rëndësishëm. E dyta, shpesh përdorni alibinë që Bashkimi Europian ndan rajonet e mëdha deri në 800 mijë veta. Okej, por nuk ka asnjë kufizim se sa numër bashkish dhe komunash duhet të ketë brenda këtij koncepti. E treta, keni konceptin e njësisë administrative. Është antidemokratik, sepse është administrativ. Duhet të ktheheni në komunitat, t'i zgjedhin vetë kryetarët e tyre dhe mos kini merak për kapacitetet, sepse në fund të fundit ne e dimë që Bashkimi Europian vepron në bazë të një parimi që është parimi i subsidarit të tij, parimi i zëvendësimit. Kur dështon lagjja, përgjigjet komuna. Kur dështon komuna, përgjigjet qarku. Kur dështon vendi, hyn Bashkimi Europian me të gjitha mjetet dhe ndihmat e tij që mos të çënohet jeta e përditshme e qytetarëve. Në qoftë se këto parime nuk mbahen parasysh, është shumë kritike. Tjetra, zoti Mazniku, situata nuk është aq e rëndë sa ju e paraqisni, aq më tepër në Vlorë. 6 monedhë që themeloi Bashkimi Europian thotë: "Institucionet janë shumë të rëndësishme, por njerëzit që u besojnë këto institucione janë akoma më të rëndësishme." Në Vlorë vjen kryetari i partisë, sillet si kryetar i bashkisë dhe pushon 24 veta njerëzish, që është një provë e qartë që reformat e kanë çënuar rëndë demokracinë. Reformë pa demokraci nuk ka. Në qoftë se mungon demokracia, vjen autokracia. Kështu që mos të merremi me territorin, mos të merremi me elementët e tjerë. Ka kaç kohë. Një bashki ka një organigram, organigrama ka strukturat, për strukturat bëhet job description, me job description përcaktohet vendimarrja dhe gjithçka është okej. A do të ketë komuna ose bashki që do jenë në vështirësi? Po, le të ketë. Prandaj bëri shpërndarje shteti, por raporti me shtetin është ai që quhet taksë moraliteti. Si përdoren taksat e qytetarëve dhe këtu marrja e kompetencave. Unë në vitin 2014 jam ftuar nga Instituti Demokratik Amerikan dhe ka qenë i deleguar një nga personalitetet më të larta. Ai është kandidat i bëhet president nga Partia Demokratike në 2004, Harvardin. Kemi diskutuar gjatë dhe unë kam mbrojtur idenë që shkurtimi i bashkive do varfërojë fshatrat, qoftë në aspektin ekonomik, qoftë në aspektin shpirtëror. Kështu që çdo reformë që do ketë si qëllim të reduktojë numrin e bashkive dhe komunave do të jetë në thelb një dështim i dytë. Besoj kaç për sot. Do ta shikojmë materialin dhe do kontribuoj në vazhdim. Gjithë të mirat. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit, zotëria. Në radhën e parafundit atje dhe pastaj Gjergji.

Sokol Hodaj:

Unë quhem Sokol Hodaj nga Bashkia e Selënitës. Aktualisht jam përgjegjësi i ujësjellësit të Selënitës. Kritikën e kam të parën për juve, zonjë, që drejtoni gjithë këtë takim, që të mbani orarin në rregull për të gjithë që flasin.

Valbona Karakaci:

Duke filluar tani nga ju. Jo, jo,

Sokol Hodaj:

Jo jo filloje nga zotëria, nga Boçi, që kaloi tre minuta. Në lidhje, të lutem, unë do flas çfarë mendoj në lidhje me... Po, të lutem. Ju lutem. Ju lutem. Urdhëro.

Valbona Karakaci:

Ju lutem, pak qetësi. Ju lutem, do keni mundësi të flisni të gjithë. Ju lutem. Po, unë doja të ngrija dy shqetësime në lidhje me...

Sokol Hodaj:

Ëh, o zonjë, ata të tjerë që s'u prezantuan është problem i tyre, se kush ishte Dhuli, e njohim të gjithë, se kush ishte ish-ministri Malaj, e njohim të gjithë, se kush... Unë u prezantova se dua të ngre një shqetësim në lidhje...

Valbona Karakaci:

Ju lutem, ju lutem, do ta merrni. Ju lutem. Ju lutem, do keni mundësi të flisni të gjithë. Po, ju lutem.

Sokol Hodaj:

Mund të vazhdoj në lidhje me reformën që po diskutoni. Unë, duke qenë se kam punuar në pushtetin vendor, do ju këshilloja. Këtu do këshilloj, do këshilloja Maznikun, jo këtë zotërinë që tha janë 40 kryetarë në gjykatë, se po të jetë rezultati pesë me pesë me pesë, kështu do jenë. Këta do jenë, se ata pesë s'ka se si të vijjnë. E kam me Maznikun të këshilloj që në lidhje me mbështetjen e fshatit dhe të fermerëve të kjo reformë që do bëhet, të shikohen shumë se si do mbështetet bujqësia. Ka mundësi të mbështeten fermerët, blektorët, të mbështeten si në shtetin fqinj, si në Kosovë. Të lutem, në lidhje me kryetarët e fshatrave, se kam qenë dhe kryetar komune dhe nënkryetar bashkie. Kryetarët e fshatrave, kryetarët e fshatrave kanë mundësi të bëhen me pagesë, sepse kanë një funksion shumë të madh në pushtetin vendor, të bëhen me pagë mujore. Është e mundur se kanë një rol shumë vendimtar kryetarët e fshatrave në lidhje me mbështetjen e fermerëve dhe në t'i mbështesim të paktën minimalisht si Kosova, fermerët, blektorët, se tani po kthehem nga fshati Matogjinë. Kam qenë në punë, kam parë kope me bagëti në rrugë, ndërkohë në Kosovë po marrin 30.000 lekë, 40.000 lekë për një bagëti. Ne vazhdojmë me 12.000 lekë. E kam me ty, zoti Mazniku, se votoj për ty. Ta mbështesim, ta mbështesim blektorin, ta mbështesim blektorin sa të mundim, pa këta të tjerët lart e më lart do ven. Nuk diskutohet. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Po, të faleminderit. Gjergji, ju lutem. Gjergji, ka kërkuar. Gjergji, ju lutem. Do ju, do jua japim të gjithëve fjalën. Do ketë kohë për të gjithë. Gjergji, pastaj Mar. Gjergji, ju lutem. Po, ju lutem.

Gjergj Nika:

Atëherë, unë jam Gjergj Nika, anëtar i këshillit bashkiak nga opozita. Ëh, unë të them të drejtën, të them të drejtën, nuk e dija që pesëshen e reformës administrative territoriale e kishim nga zoti Çuçi në 2014. Më kishte dalë nga mendja, por këtu nuk është ideja si si organizohet reforma. Problemi është që edhe në qoftë se do ta kishim bërë tamam në 2015-ën, që ka qenë e gabuar, sepse është një reformë politike, ne e prishim rrugës, ose më saktë ju e prishni rrugës, partia në pushtet, sepse siç thatë ju, zoti Mazniku, ju i dhatë në 2014-15-ën, bashkive u dhatë 20 kompetenca të reja. Nga ato 20 kompetenca të reja, në gjithë këto vite ju ja keni hequr bashkive kompetencat. Në radhë të parë, njëherë, bashkitë duhet të decentralizohen brenda vetes. Ëh, reforma e 2015-ës ka dështuar, sepse kishte në zanafillën e vet, kishte kostot, kishte dhe afër shërbimin më afër qytetarëve dhe uljen e kostove. Asnjëra nuk ka ndodhur. Shërbimet janë shumë larg qytetarëve, kostot janë rritur marramendëse. Ajo që ju thatë për pjesën e pagave ka qenë 73%, 72%. Po t'i futemi lojrave me përqindje, normalisht dalin lojra, nuk dalin përqindjet, sepse unë sa herë që në çdo mbledhje të projektbuxhetit diskutoj që pagat vënë 50%, ju thoni mesatarja 43%, bashkia e Vlorës këto 34%. Kështu që nuk jemi në atë ritëm. Për sa i përket pjesës që ju thatë, që Komisioni Europian ka nxjerrë një rezolutë që përgëzon këtë reformë administrative territoriale, dhe kjo reformë duhet përgatitur në një mënyrë të tillë që në 2030-ën t'i përshtatet edhe pjesës së Bashkimit Europian. Unë ju sugjeroj që rezolutën e Komisionit Europian ta lexoni përtej rreshtave ose atyre dy rreshtave. Mund ta lexoni edhe që korrupsioni, çështja Balluku, e pengon Shqipërinë për të shkuar në Europë në 2013-ën dhe duhet të bëjë një rol më të fortë kundër korrupsionit. 2030-ën, po. Ideja është kështu që për sa i përket bashkive, duhet të decentralizohen, jo të centralizohen. Në këto 10 vite ju keni centralizuar gjithçka, ashtu siç tha edhe zoti Dhuli. Ne kemi votuar bashkinë që edhe ujësjellësi të jetë pjesë e bashkisë, edhe policia bashkiake, që në informacionet e mia kam një informacion që do i kalojë Ministrisë së Endit, edhe pjesa e landfillit do jetë në funksion të bashkisë, do t'i kalojë pjesës tjetër. Kështu që duhen centralizuar, duhet decentralizuar. Nga 373 i bëtë 61, i bëtë për arsye politike. Shumë mirë i kemi diskutuar shumë herë, por ajo që unë do sugjeroja, të paktën për pjesën e bashkisë së Vlorës, duke qenë se jam dhe ekspert, unë mendoj që Vlora duhet të ndahet në tre bashki. Bashkia e Vlorës të jetë një bashki urbane, e cila përket mban Vlorën, mban dhe Orikumin dhe pjesën e turizmit, duke qenë një bashki e fokusuar te turizmi, por edhe te pjesa urbane. Të jetë një bashki agrorurale, e cila mund të përqendrohet shumë mirë në zonën e Novoselës, duke përmbledhur dhe pjesën e Novoselës, duke qenë një bashki tjetër. Dhe Bashkia e Selënicës në asnjë moment nuk duhet bërë xhep i Bashkisë së Vlorës. Bashkia e Selënicës duhet forcuar. Bashkia e Selënicës duhet forcuar, duhet fokusuar te pjesa e industrisë që ka pjesën minerare, duhet fokusuar te energjia dhe te bujqësia e kufizuar. Kështu që kjo do ishte mënyra më e mirë e ndarjes, në mënyrë që të ulim kostot. Më lejohet një minutë, duke

qenë që nuk ka ndonjë problem. Ah, okej, në qoftë se them gjëra me vlerë, nuk ka problem. Në qoftë se flas broçkulla, pastaj është pjesë tjetër. Kështu që mendoj, ju lutem, duhet ta përmbyllni. Po, atëherë unë mendoj që, atëherë mendoj që reformat territoriale administrative duhet të bëjnë një reformë ekonomike dhe të lihet pjesa politike jashtë. Në qoftë se i futemi pjesës politike, përsëri do dështojmë. Ne bëjmë reforma shumë herë, sepse dështojmë. Fakti që ne i përsërisim reformat janë pjesë e dështimit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, ë, zotëria, dhe pastaj Romario. Zotëria, ju lutem, tani do duhet që edhe gjeografikisht të shkojmë pak edhe këtej, edhe këtej. Para për zotëri, ju lutem, para për të dëgjuar të gjithë. Nuk më bjerë edhe do ju bjerë. Okej, okej, ë, a mund ta respektojmë për moshën? Po, ju lutem. Ju lutem, a mund të, a mund të prezantoheni, ju lutem?

Ridvan Mersini:

Quhem Ridvan Mersini. Kam post politik, po këtu jam qytetar i Vlorës dhe ndihem shumë mirë si qytetar. Dhe më bëhet shumë qejfi që shoh mazhorancën dhe opozitën bashkë, se më duket dhe atje lart punoni bashkë. Më duket mazhorancë dhe opozitë. Tani unë nuk dua të përsëris ato fjalë që përsëritën zotërinjtë, po dua të ndalem pak. Vlora ka një problem dhe qytetarët e Vlorës e ndjejnë. Dhe kur ulemi në kafene dhe pimë një kafe, e gjithë administrata që është këtu ta dëgjojnë, dhe detyruesit e Partisë Socialiste na thonë një fjalë, por nuk e thonë dot se kanë frikë. Tërmen se mos ju hiqet buka dhe mos ju hiqet puna. Ndërsa kur janë pranë nesh dhe bëjnë muhabet të lirë, të gjithë e thonë me shpirt që ne po vuajmë shumë me marrjen e kompetencave të pushtetit vendor, të rrëmbyera nga pushteti qendror. Sot në Vlorë, ajo që çdo vlonjat e vuan më tepër se kurrë, i hiqet e fundit edhe kadastra dhe e çojnë në Vlorë. Përse në Tiranë? Sa detyra u ndërjuan në Vlorë dhe kush është motivi i ndërrimit të detyrave? Këtë duhet të na e thonë detyruesit e mazhorancës që kanë 14 vite dhe spas kanë ngopur. Duan akoma deri në 30-ën. Qerbet uji kur rri në vend. Kështu i thërrisni mendjes. Nuk e keni Shqipërinë vetëm ju. Shqipërinë e kemi të përbashkët. Duhet të kontribuojmë të gjithë. Dhe Amerika tetë vite e ka. Nuk lejon më tepër. Iku kjo. E dyta, edhe detyria e ujërave. Po këta nuk e thonë. Shkoi prapë në Tiranë. Arsimi, detyria ka shkuar në Lushnje. Nuk e di çfarë detyrash të tjera i kanë hequr Vlorës dhe i kalojnë dhe i çojnë nëpër rrethe dhe qytete të tjera. Ju lutem shumë, Vlora ka shumë dhe unë kam shumë për të thënë, po do them dy fjalë që t'i dëgjojnë dhe këta të mazhorancës. Edhe opozita t'i dëgjojë mirë detyruesit e saj. Unë i përkas shtresës së përndjekurve politikë. E kam paguar me gjak. Tani çfarë është bërë për të përndjekur politikë? Dhe nuk ndihet ndonjë nga këta që fërkojnë barkun dhe sot kanë dhe festën e dëshmorëve. Takzojnë ata që kanë kontribuar në luftë kundër okupatorit, po jo ata që janë bërë, që janë vlarë në fushë dhe janë bërë dëshmorë. Dhe tjetra, po për këta të përndjekur politikë që janë vlarë në krimet e komunizmit, pse nuk ndihen shoqëria 36-vjeçare politike? Po, po, për ju janë zoti detyrues. Me lidhje me përbashkitë. Dhe tjetra, atë do e tregoj historia. Po, tjetra, problemi i pronave. Do ta mbyll tani, zonja e nderuar. Ne pronarët e lirshëm jemi bërë një dritare e hapur për reformën e '91-shit, ligjin e famshëm 7501, që çdo shqiptar u krenua me dy dylmë për frymë. Sot ju, me këtë paketën e maleve, me investitorë strategjikë, po ja u merrni dhe këtyre që ju ia keni dhënë me 7501. Do ua merrni ju, se nuk keni të

ngopur. Ata që janë investitorë strategjikë, ata do ua rrëmbejnë. Pasi e patë një skenë që e bën një gjyshe atje në Durrës, në Golem. E vdiqën. E vdiqën. Do ta përmbyll unë, po e realiteti është i hidhur. Mos u mërzi. Jo, nuk mërziem, po duhet ta përmbyll. Do ta përmbyll. Dhe tjetra, jo e fundit. Ju lutem, çfarë bëhet me pronat në Tiranë, me kthimin dhe kompensimin e pronave? Kthimi, kompensimi i pronave. Faleminderit. Po jeni për bashkëqeverisje dhe jeni për territoriale, po këto janë shqetësime që ne i kemi dhe duhet t'i themi. Ju faleminderit. Faleminderit

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, zotëria. Dhe pastaj për paritetin. Po, për paritet politik. Pastaj do flasi Ina dhe kthehem tek... Po, faleminderit. Shkurtimisht do flasi Ina. Pastaj, po, do flasi Ina. Faleminderit. Shkurtimisht patjetër. Dakord, dakord.

Ardit Bido:

Shkurtimisht dua të theksoj në radhë të parë që nga reforma e 2014-ës ne kemi marrë mundësinë që ato komuna të cilat kanë qenë të vogla, të varfra, të cilat kanë pasur popullsi të vogël, shumë punonjës dhe aspak investime, sot të kemi mundësinë që të shohim rrugë të asfaltuara brenda fshatrave për herë të parë. Dhe këtë dua ta thjeshtëzoj debatin e reformës së fundit territoriale te efekti ekonomik që ai ka dhënë, si një efekt i cili mundëson zhvillimin më të mirë dhe jetesën më të mirë të banorëve në tokë. Thënë kjo, dua të përqendrohëm në atë që unë gjykoj se është thelbi se si ne duhet të shohim reformën e ardhshme territoriale. Ne duhet që të arrijmë një reformë të tillë e cila mundëson të plotësojë tre parakushte. E para, ekonominë, që ekonomia mund të realizohet vetëm përmes ekonomisë së shkallës. E dyta, identitetin, sidomos në këtë qark ku ne kemi çamërinë në Konispol, minoritetin në Finiq, labërinë në Delvinë, labërinë në Selënicë të shpëputur nga labëria bregdetare e Himarës, Myzeqenë e kështu me radhë. Elementi identitar nuk duhet parë si diçka e cila nuk është pjesë e reformës territoriale, sepse në të gjitha praktikat më të mira botërore, krijimi i hapësirave, krahinave gjeografike dhe kulturore përbëjnë parakusht për reformën territoriale. Momenti i tretë ka të bëjë me shërbimin dhe afrimin e shërbimit sa më afër qytetarëve. Tani këto të treja mund të duken kundërtëna, por janë të shumta modelet të cilat mundësojnë edhe arritjen e ekonomisë së shkallës, pra të hapësirës më të gjerë, të mundësimit të bashkive, pra më të mëdha në kuptimin ekonomik, apo të qarqeve, apo të çfarëdolloj njësie të vetëqeverisjes vendore, dhe njëherazi të mundësojnë të zgjedhur, përmes të zgjedhurve, arritjen e këtyre objektivave të cilat kanë të bëjnë me njësi më të vogla. Dhe për ta përmbyllur, dua ta marr një shembull që s'dua të marr asnjë bashki këtu, sepse janë të gjitha bashkitë, janë, janë, le të themi, miqtë tanë. Saç nuk ka kuptim që në një pikë kufitare që ne kemi fshatra, në pika që janë të ndara mes dy bashkive, t'i kalon nga 100 milionë euro në 3 milionë euro buxhet, ne t'i kalon nga 80 milionë euro në 2 milionë euro buxhet, nga 40 milionë euro në 2 milionë euro buxhet, dhe të gjithë e kuptojmë për cilat ato bashki, sepse pikërisht. Por nuk është se meritojnë ato fshatra të cilat janë në bashki me 100 milionë euro më shumë sesa ato fshatra që janë bashki me 2 milionë euro. Qytetarët meritojnë njësoj. Po aq është e rëndësishme që të ruhen elementet e shërbimit akoma dhe më afër sesa janë sot, dhe elementet identitare të krahinave si Konispoli, si Finiqi, si Delvina, si Selenica, e kështu me radhë, brenda së

njëjtës reformë territoriale. Nëse ne arrijmë në këtë ekuacion që të biem bashkë në radhë të parë dhe të mos e kthejmë në politikë, siç nuk po kthehet, fatmirësisht, që të arrijmë në këtë ekuacion, të përputhim këto dy momente, atëherë unë besoj se do të kemi bërë një reformë territoriale që do të jetë edhe më e mirë sesa ajo që kemi dhe që ka dhënë rezultate suksesshme.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Ëh, Ina dëshiron ta marrë më pas. Romario, se ja dhashë, ja dhashë, dhe pastaj bashkia e Finiqit. Po, po, ju lutem. Po, do kemi mundësi. Do kemi mundësi të gjithë. Po, ju lutem. Po.

Romario Meminaj:

Përshëndetje. Unë quhem Romario Meminaj, me profesion avokat. Vij nga njësi administrative Novosel. Në radhë të parë, doja të shpjegoja pak reformën. Unë do ta quaja reformë politike, totalisht ajo e vitit 2014-2015, që hoqi ish-komunat dhe i bëri një bashki të vetme për të vetmen arsye për hambarin e votave të Partisë Socialiste. E dyta, unë do të isha që të ndahen në bashki urbane dhe bashki rurale, sepse dhe natyra e problematikave është e ndryshme si ajo e bashkisë urbane dhe e bashkisë rurale. Bashkia urbane ka problematikat e saj: ka turizmin, ka menaxhimin e rrugëve urbane, ka menaxhimin e mbetjeve, e plehrave, ndërsa bashkitë rurale kanë si fokus, kanë menaxhimin e tokave bujqësore, prodhimin, subvencionimin, prodhimin që atyre fshatarëve në zonë u ngelet stok, si ai, për shembull, në bashki, në ish-njësinë administrative Novosel. Shumica kanë frutikulturë, vreshta dhe ullinj, dhe pak blektori. Do të kërkoja që të mblidhen njësi administrative Novosel, Shushic, edhe qendër të bëhet një bashki rurale. Dëgjova zotin Maznikush me shumë krenari që kemi ndërtuar shumë shkolla. Tha: "Për çfarë shkollash? Shkolla Aliban, Cerkovin, Mifol, Akërnj janë të mbyllura, sepse janë larguar dhe janë të mbyllura, janë mbyllur në vitet 2015 e më pas, për shkak të keqmenaxhimit të reformës territoriale që i bërit ju, i bëri Partia Socialiste." Ju faleminderit.

Valbona Karakaci:

Shumë faleminderit. Edhe për kohën, po, bashkia Finiq, dhe do doja një zonjë atje që të paktën të flasi edhe një zonjë. Ju lutem. Po, bashkia Finiq. Ju lutem, dhe pastaj zonja atje. Bashkia Finiq. Po, mos harroni.

Vangjel Anagnosti:

Unë jam Vangjel Anagnosti, jam qytetar i bashkisë së Finiqit. Erdha në këtë dëgjim publik, faktikisht për të thënë mendimin tim, edhe dëgjimet publike janë të nevojshme, po bëhen kaq shumë të mëdha në një hapësirë gjeografike kaq të madhe, nuk kanë kontribut. Besoj se do ishin bërë dy dëgjime publike: një për Vlorën dhe një për Sarandën, një për tre bashkitë e Vlorës dhe një për katër bashkitë e Sarandës, se dhe figuracioni, po edhe njerëzit atje kanë mentalitete të ndryshme. Thoni ju financat, domethënë janë bashki që nuk bëjnë, nuk kanë mundësi të mbajnë veten. Keni bërë ju studime të pavarura se sa mundësi ka një bashki për të, për financat e saj? S'keni bërë. Ajo që thoni juve është varet nga kryetari i bashkisë dhe nga aparati. Në qoftë se ata

nuk punojnë, ju quani bashkinë të dështuar. Kjo është gabimi më i madh që bëni. Të gjitha bashkitë janë, kanë aq shumë politesë në qoftë se ju, si shtet, ju, si qeveri, do t'i lini të lira. Jo, në çdo pesë vjet, në çdo 10 vjet, vazhdoni të bëni reforma të reja të cilat nuk do kenë asnjë efekt. Po marr punonjësit. Unë kam qenë kryetar i komunës së Levadias për një, për tre legjislatura, dhe më vinte organika nga shteti: 11 plus 1, Dhjuri 7 plus 1, Mesovotami 8 plus 1, Aleko 5 plus 1, Finiqi kaq plus 1, 50. Tani janë 250 veta. Kush i paguan ata? I paguajmë neve. Pse ka 250 veta? Se kryetari i bashkisë, duke qenë një person politik, shikon votat e tij. Mund të lë një fshat pa rrugë, po duke marrë pesë veta në punë, atëherë ata do t'i sigurojnë votat. Bëni studime, bëni studime të ndërruara se sa duhet të ketë bashkia e Finiqit, dhe këto studime mos i bëni ju, politikanët, po jepni akademikëve, jepni ekspertëve, i dërgoni bashkisë së Finiqit ose bashkisë së Sarandës ose bashkisë tjetër se sa duhet të jetë struktura, me qëllim që mos të thoni pastaj që një tjetër që kam është kryetarët e fshatrave. Ata zgjidhen në ca mbledhje, në ca, në ca, në ca që s'merret vesh, vendosin të zgjidhin kryetarët e fshatrave në momentin që bëhet zgjedhja për pushtetin vendor. Në atë moment vendosin një kuti të dytë. Ai që do jetë kryetar të marrë po ato vota sesa të marrë votave të tjerave. Ju faleminderit. Një minutë, s'më mbaroi koha. Okej. Po, po. Ne jemi dhe një bashki minoritare. Jemi 60 fshatra të bashkisë së Finiqit. Kemi dhe katër fshatra shqiptarë. Jemi jashtëzakonisht në rregull. As në mos na bashkoni, as mos na ndani. Na lini të qetë, se kemi të njëjtën kombësi, kemi të njëjtin identitet, kemi të njëjtën gjuhë, dhe mos na ngatërroni me këto ndarjet, kësendarjet, pësondarjet.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Ju zonjusha, ëh, pastaj Lavdoshi një person të shoqërisë civile, zoti Hoxha, pastaj.

Sildi Koqini:

Përshëndetje të gjithëve. Sildi Koqini, anëtare e këshillit bashkiak të bashkisë së Konispolit dhe aktiviste e të rinjve të komunitetit çam. Ëh, është kënaqësi të flas sot për një element tjetër. Unë nuk e kam kërkesë logjike më shumë sesa e kam kërkesë zemre, dhe shpresoj shumë që të merret parasysh kur ju të hartoni reformën e re të ndarjes territoriale. Unë jam shumë dakord që duhet mbajtur parasysh si numri i popullsisë, si dhënia e shërbimeve në mënyrën më efektive dhe më eficiente të mundshme për të gjithë qytetarët e të gjithë bashkive. Por në qoftë se për bashkitë e tjera të qarkut të Vlorës nuk është aq shumë i rëndësishëm identiteti apo historia kulturore, për bashkinë e Konispolit është një nga elementët për mos të thënë më i rëndësishmi, sepse bashkia e Konispolit është sot çamëria që ne na ka ngelur në Shqipëri, është ish-nënprefekturë e Çamërisë dhe është i vetmi institucion shtetëror që përfaqëson krahinën e Çamërisë. Në qoftë se unë nuk dua as ta mendoj, jo të, jo ta besoj që do të bëhet realitet shkrirja e bashkisë së Konispolit apo bashkimi me bashkitë e tjera, sepse në qoftë se Konispolit i heqim bashkinë, krahinës së Çamërisë i heqim të vetmin institucion shtetëror që e përfaqëson. Kështu që unë do t'ju lutesha ta kini këtë si një pikë në ndërgjegje për t'i dhënë edhe kësaj popullate atë që ndoshta historia ja ka mohuar. Faleminderit.

Faleminderit. Po, Lavdosh. Zoti Hoxha. Dhe pastaj zoti Hoxha. Po, zoti Hoxha. Zoti Hoxha.

Lavdosh Ferruni:

Faleminderit që më datë fjalën. Unë jam ekspert i zhvillimit rural, edhe pse dikush mund të më njohë pak ndryshe, por kjo është edukimi im edhe ngrada shkencore që kam. Ëh, si ekspert rural, unë kam bindjen absolute të konsoliduar nga shumë studime që qytetet rurale janë zgjidhja perfekte për një zhvillim të qëndrueshëm të Shqipërisë. Qytetet rurale, që do të thotë, përkthehet në këtë takim që kemi sot me rritjen e numrit të bashkive, ku një edhe një hapësirë rurale të jetë një qytet me të gjitha shërbimet e tjera. Kaq në mënyrë telegrafike për këtë gjë. Edhe një rast konkret për rastin. Falenderoja djalin që ka atë tabelën aty "Orikumi Bashki" për arsye se e meriton. Ka një fshat aty, Dukat, nga është origjina ime, dhe ku banoj tani, se kam ikur nga Tirana, jetoj aty. Është lagje nga dy dete dhe është një fshat që janë 54 fshatra në botë si ai, dhe e meriton, e meriton me gjithë asetet që ka. Nuk po e përmend tani që të jetë bashki më vete. Orikumi. Për këtë gjë kam edhe një precedent që e bëj publik këtu. Kam bërë një takim me zotin Çuçi kur filloi reforma në 2014, bashkë me disa përfaqësues të tjerë nga krahina, dhe na u tha nga zoti Çuçi që jeni pak vonë me këtë. Domethënë, me idenë që kjo bashki e meriton të jetë më vete, po jeni vonë. Kështu që ndoshta korrigjova tani. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Po, ëh, zoti Hoxha dhe pastaj zonja, nëse është e mundur t'i japim dy zonjave fjalën. Kanë folur 12 burra. Të flasim me dy zonja.

Atird Hoxha:

Po. Ëh, faleminderit. Ashtu siç edhe ju thatë, unë quhem Atird Goxha, jam anëtar i këshillit bashkiak të Partisë Demokratike në bashkinë e Vlorës. Me thënë të drejtën, erdha në këtë takim me idenë që do dëgjoni më shumë qytetarët sesa do flisnin këtu, të paktën përfaqësuesit politikë. Po duke parë që po flasim të gjithë, flasim deputetët, mendoj që është një arenë ku duhet të dëgjoheshin qytetarët dhe jo politikanët. Megjithatë, kam për të thënë dy gjëra sa i përket edhe referimit dhe kryesisht ë reformës administrative territoriale, e cila në vitin 2014-2015 u inicioua si një reformë e cila do të zbehte ose do të paksonte burokracitë, do të paksonte numrin e punonjësve dhe do të sillte më shumë shërbime dhe do të rriste më shumë efikasitetin e financave të bashkisë. Për fat të mirë, kam qenë dy herë anëtar i këshillit bashkiak dhe çdo vit miratojmë atë buxhetin e bashkisë, i cili, për fat të keq, nga viti 2015 që është implementuar kjo reformë, nuk i ka plotësuar asnjë vit të vetëm të gjitha këto kritere mbi të cilat u organizua dhe u miratua kjo reformë. Po të hyjmë tek financat, ashtu siç tha edhe kolegu Nika, unë mendoj që për vite të caktuara mund të kemi deri diku dakordësi, por për shumicën e këtyre viteve, këtyre 10 viteve, financat kanë qenë plaga më e madhe e bashkive. Mendoj që janë dy gabime në të cilat duhet të fokusohet ky takim sot, dhe mendoj edhe njerëzit të cilët janë këtu. Po flas vetëm për këtë pjesë të territorit të bashkisë së Vlorë, që është bashkia Orikumi, e cila ka mundësi financiare, ka kapacitete intelektuale për t'u drejtuar, sepse u tha këtu që s'kanë njerëz, s'kanë kapacitete

financiare. I ka të dyja. Madje, po ju them që një pjesë e mirë e buxhetit të bashkisë së Vlorë mbushet me të ardhura që vijnë pikërisht nga ky territor, nga bashkia Orikumi. E njëjta gjë dhe për specifikat që tha edhe zoti Memina e sa dëgjova, bashkia Novosel. E para një, që janë shumë fshatra që janë jashtë vëmendjes totale të pushtetit vendor, shkollat po mbyllen, qendrat shëndetësore nuk ekzistojnë më. Ato zona kanë nevoja dhe specifika për të cilat mund t'u gjenden kryetarët ose ish-kryetarët e komunave apo bashki rurale, sido që të quhen ato, po të jenë me buxhetimin e tyre, sepse ata kanë hallin e kanalit të vaditës, nuk kanë hallin e Lungomares në Vlorë. Jo se Lungomare nuk e duan ata, e duan dhe ata qytetarët atje, por ata kanë hallin e kanalit që të vadisin ato të mirat materiale për familjet e tyre dhe për ekonominë familjare apo për bagëtinë e tjera si këto. Në të njëjtën kohë, mendoj që shërbimet janë larguar shumë nga qytetarët, dhe këtu e kam fjalën edhe për një centralizim që qeveria u ka bërë disa shërbime, siç janë lejet e ndërtimit. Duhet të shkosh te AZT-ja të marrësh lejen e ndërtimit. Për parcelat e plazheve që marrin sot bizneset në Vlorë, duhet të veshë të aplikosh te Agjencia Kombëtare e Bregdetit për të marrë. Ajo menaxhimi i mbetjeve po shkon përsëri në Tiranë. Ujësjetllësat kanë ikur në Tiranë. Pra, kush është këtu kompetenca që u janë dhënë bashkive dhe që bashkitë ua kanë kthyer qytetarëve në të mira për ato çka ata paguajnë? Taksa dhe tarifat, që është një element shumë i rëndësishëm dhe e mbylla, kërkojmë pjesë, është shumë e rëndësishme. Ata në Novosel dhe ata në Dukat paguajnë njësoj si ata në Skelë: pastrim, gjelbërim, kanalizime, ku dëgjon se çfarë të tjera. Janë të diskriminuar sepse paguajnë sikur jetojnë te rrethi i Skelës, ndërkohë jetojnë në Fitore dhe në Dukat fshat. Ju faleminderit.

Valbona Karakaci:

Zonja dhe pastaj zonja në radhë. Po, dy zonja. Ju lutem, dy zonja.

Meme Abazaj:

Përshëndetje. Ëh, jam Meme Abazaj, inxhinierë hidro, pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, sepse jemi transferuar nga Vlora në Fier. Ajo që unë dua të prek këtu, së bashku me reformën territoriale, u bë edhe në 2015 transferimi i drejtorive. Pranë, ëh, drejtoria jonë u bashkua me Fierin dhe kështu u ndanë në katër borde. Gjithsesi, unë dua të theksoj disa problematika që kanë të bëjnë me këto sisteme të ujitjes dhe të kullimit që kanë kaluar pranë bashkive, që u transferuan te bashkitë. Bashkitë e kanë dëshirën dhe mundësinë shumë të madhe. Ligjet janë, por ëh, është një pengesë shumë e madhe, sidomos hipotekimi i tokave, sepse ëh, banorët, fermerët nuk e kanë hipotekën e tokës në dorë dhe kur shkojnë për të mirëmbajtur sistemet e ujitjes dhe të kullimit, ai thotë: "Unë e kam tokën deri në buzë kanalit, largo këtej." Janë probleme shumë jetike dhe shumë të prekshme dhe shumë të ndjeshme, të cilat duhen njëherë e mirë të marrin fund. Të gjithë janë me probleme. Kjo ishte e para. E dyta është mbetjet që hidhen për këto sisteme të ujitjes dhe të kullimit, që Vlora gjithmonë e ka shumë problem dhe po të shkojmë dhe sot në këto sisteme që janë transferuar pranë bashkive, janë prapë të bllokuara. Ëh, dhe e katërta, në lidhje me këtë situatë, e kam për lumenjtë. Në lumenj ka dekantime të mbeturinave dhe njëkohësisht, ëh, unë e kam ngritur dhe njëherë këtë si shqetësim pranë një takimi me ministrin tonë të bujqësisë. Përfitoj nga rasti që jeni dhe ju, zotërinj parlamentarë, një pjesë. Ëh, dua të them në lidhje me sistemimin e shtretërve

të lumenjve, sepse tokat që ne i kemi shumë të pakta, po i marrin Vjosa dhe Shushica, pasi ëh, në mes të Vjosës janë krijuar ishuj me tokë, duke gërryer tokat e selenicës. Shumë banorë atyre u është marrë toka dhe u rrezikohet toka, u rrezikohen bagëtitë që kanë të mbrojtura aty. Dua të them një vendim të Këshillit të Ministrave për zonat e mbrojtura, se është park kombëtar dhe Shushica dhe Vjosa, një VKM që të na lejojë ne, jo të prishim, po të ndreqim, të sistemojmë shtretërit e lumenjve në mënyrë që t'ju vijmë në ndihmë të gjithë banorëve. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Ëh, zonja, pastaj Juli. Po, po, ju lutem.

Aleksandra Arshia:

Atëherë, përshëndetje. Respekt për komisionin. Ëh, unë jam Aleksandra Arshia, jam anëtare e këshillit bashkiak selenic nga Partia Socialiste. Ëh, është i dyti mandat rresht që vazhdoj të jem anëtare e këshillit. Duke qenë shumë pranë komunitetit, duke i gjuar njerëzit, duke qëndruar pranë tyre, të fokusohemi tek reforma territoriale, tek pika e parë. Unë mendoj se është shumë e vështirë, në qoftë se të paktën nga zona jonë që kemi të bëjmë me ëh, pensionistë, me njerëz që janë në, nuk janë në mes të qytetit, por janë në një zonë rurale, është domethënë, në qoftë se e prekim me reformën territoriale këtyre njerëzve, nuk do t'ju bëhet shërbimi siç duhet dhe kjo është më se e sigurt dhe më se e bindur që them unë. Duhemi t'i dëgjojmë edhe ta marrim opinionin e tyre. Për sa i përket financave, duhet t'i investohet më shumë, them unë, nga qeveria, që kryetari të ketë më shumë financa dhe t'i investojë më shumë në bashkinë e Selinicës. Për sa i përket shërbimeve, unë mendoj se shërbimet i marrin aty ku janë dhe nuk besoj se ka ndonjë qytetar, të paktën te bashkia ku jemi ne, që të mos t'i ketë munguar shërbimi. Për këtë jam shumë e sigurt. Edhe kjo pjesa se dëgjoja zëra po na ka bërë, na ka bërë reforma bashkë, se e kemi çik të vështirë e trimë bashkë këtyre fjalët. Urdhëro, urdhëro. Po, ju lutem, ju lutem, fokusohuni tek mesazhi juaj. Po, atëherë mesazhi im është t'i bie shkurt edhe qartë. E para që bashkia e Selinicës të mos preket te reforma territoriale. Kjo është çështja, sepse është një bashki rurale edhe duhet, domethënë, duke edhe me investimet e qeverisë që po investohet, turizmi malor, shumë të tjera, mund t'ju e marrin shërbimin shumë mirë aty ku duhet, se nuk i më bezdisin kur flasin në korë. Mund ta marrin mikrofonin dhe të flasin dhe veç e veç. Pjesa tjetër te shërbimet, i marrin shërbimet prapë te investimet. Kanë marrë, kemi marrë investime, sepse nga taksa që mbet bashkia janë bërë rrugë që s'kanë qenë kurrë në mendje për t'u bërë ato rrugë dhe ne e dimë shumë mirë këtu, të paktën ne që i përkasim Selinicës, çënësi ka se të kujt jemi, të kujt bindje. Janë bërë rrugë nëpër fshatra, janë bërë investime. Te shërbimi i qytetarëve, shërbimi i qytetarëve është u bëhet aty ku janë. Zero mbajtje, se unë e di që shërbimi i qytetarëve është shumë mirë. Mund të vemi të dy bashkë edhe t'i dëgjojmë. Kjo që me zë të fortë do kërkoja që mos të preket territori i Selinicës. Mundësisht, në qoftë se do na jepnin ndonjë njësi tjetër të tjetër të na e bashkonit në shërbim, kjo do ishte, do ishte super për ne. Zërat, zërat e dytë nuk dua t'i dëgjoj se ju faleminderit. Po dua të them një kryetar doli vetëm me pesë anëtarë në garë. Këtë do ja thosha unë dhe nuk e bëjmë dot këtu punën politike. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Ëh, Juli dhe pastaj zotëria. Zotëria, po. Juli dhe pastaj zotëria, ju lutem. Zotëria, patjetër. Po, ju lutem.

Julian Alidhe:

Po, përshëndetje të gjithëve. Unë quhem Julian Alidhe dhe vij nga bashkia e Konispolit. Ëh, janë shtruar hipoteza të shumta në rrjet kohën e fundit për shkrirjen e bashkisë së Konispolit në reformën e ardhshme territoriale dhe desha të shtroja shkurt disa argumente se pse bashkia e Konispolit nuk duhet të shkrihet. Ëh, së pari është terreni dhe pozicioni gjeografik i bashkisë së Konispolit. Bashkia e Konispolit ka një terren tërësisht malor dhe ëh, fshatrat e bashkisë së Konispolit janë shumë larg nga qendra. Tani, imagjinoni me një bashkim në një bashki më të madhe se sa do të rritej lartësia dhe vështirësia për banorët e zonës. Përveç kësaj, ëh, specifikat ekonomike të bashkisë së Konispolit... Bashkia e Konispolit njihet nga të gjithë që është një bashki blektorale dhe bujqësore. Mandarinën e Konispolit besoj se i kemi provuar të gjithë. Nuk besoj se do të rritej produktiviteti në qoftë se ne Konispolit ia çojmë Sarandës. Domethënë, ajo kryetar i bashkisë së Sarandës do merret me turizmin apo do merret me tokat dhe me blektorinë e Konispolit? Domethënë, nuk... jashtë logjikës. Dhe përveç kësaj, nuk duhet të harrojmë që bashkia e Konispolit është bashkia e vetme përfaqësuese e komunitetit Çam. Vërtet, ne jemi 10 mijë banorë votues të bashkisë së Konispolit, po ama ne në Shqipëri jemi 300 mijë banorë dhe kjo bashki na përfaqëson të gjithëve neve. Domethënë, është... në qoftë se do ta lëmë komunitetin Çam pa përfaqësim, besoj se është një goditje e madhe që do t'i bëjë këtij komuniteti. Edhe në periudhën e monarkisë së ish-bretit Zog, bashkia e Konispolit ka ekzistuar si përfaqësuese e komunitetit Çam. Kanë qenë nënprefektura e Çamërisë. E pse duhet të mendojmë sot që këtë komunitet ta lëmë pa përfaqësim? Domethënë, për mua kjo është shumë e rëndësishme. Sjell këtu edhe shqetësimin e banorëve të zonës. Edhe ne kemi bërë dëgjesat tona më të vogla në zonë, kështu që shpresoj shumë që të merret parasysh nga komisioni. Falenderoj shumë për fjalën.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Zotëria, ju lutem, dhe pastaj zotëria. Po, ju lutem. Po, patjetër. Okej, ju lutem. Do të kërkoja mirëkuptimin që të dëgjonim edhe qytetarë nga Himara për arsye se nuk e dëgjoj... Po, ju lutem. Të përshëndetje të gjithëve. Po, ju lutem. Po, zotëria Delvina, dhe pastaj duam të dëgjojmë dikë nga Himara. Ju lutem, zotëri.

Përparim Ahmeti:

Përshëndetje të gjithëve. Përshëndetje komisionit të posaçëm për ndarjen e re territoriale. Edhe Saranda. Quhem Përparim Ahmeti, vij nga Ksamili. Kam 27 vjet, jam anëtar i këshillit bashkiak, dy mandate anëtar i këshillit të Qarkut, një mandat kam qenë kryetar këshilli dhe vij këtu me bindjen të plotë që Ksamilit duhet t'i rikthehet njësi vendore, të jetë bashki me vete. Mund të të jap argumente sa do të duash. Sot Ksamili ka të ardhura sa tre herë, sa tre bashkitë. Delvin, Finitje, Konispol. Sot në Ksamili operojnë mbi 1.000 biznese që janë me NIP të rregullt, plus ata që janë me sekondar. Ëh, e argumentoj plusi, sepse të ardhurat e Ksamilit, thashë, janë një buxhet i madh që i shkon Sarandës dhe nuk e marrim atë shërbim që meritojmë të marrim. Sot qytetarët e

Ksamilit, mbasi është bërë bashki, rendin mbas dyerve të bashkisë me orë e me ditë të tëra dhe nuk arrijnë të marrin. Sot në Ksamil ka mbi 400-500 hotelierë që nuk ka marrë akoma lenë e shfrytëzimit. Ju lutem që ta riktheheni njësi vendore Ksamilin, sepse e meriton. Në vitin 2014 kam qenë kryetar këshilli dhe kam takuar ish-ministrën e pushtetit lokal, djeshpas, zotin Bashkim Fino. I kemi vajtur me 800 firma të familjarëve dhe me program konkret që na e kanë mbështetur, por pavarësisht se opozita nuk mori pjesë dhe ajo u bë tamam ndarje politike, siç thonë shumë parafolës këtu, i kemi thënë që të bëhet bashkia Butrinë me qendrën në Ksamil, duke përfshirë nga Berdeneshi deri në Shëndëlli edhe Vrin. Do të ishte një bashki model në gjithë rajonin, me frutikulturë, me turizëm, me peshkim, me turizëm kulturor, sepse ka Butrintin. Ju lutem, komisioni ta shikojë Ksamilin me përparësi për ta rikthyer bashki. Faleminderit shumë.

Valbona Karakaci:

Po, po, ju lutem. Delvina, dhe pastaj duam një zë nga Himara, me patjetër. Po, po, ju lutem, Delvina. Po, mund ta çojmë? A ka një... Ja, zot... ja dha zotërisë. Mirë, do rrijë në këmbë zotëria. Ju lutem. Faleminderit, faleminderit për lejen. Në vazhdim të... A mund të prezantoheni, ju lutem?

Besim Koçiu:

Po, Besim Koçiu, me profesion inxhinier. Përfaqësoj edhe unë komitetin e Ksamilit. Jo, jo, do t'ia japim Ksamilit sapo foli. U prezantua, ju lutem. I thashë, le të jemi... le të jemi pak parimor. Ju lutem, zotëria nga Delvina. Derisa më thotë të prezantohem, unë do ta mbaroj fjalën. Po mirë, tani. Dakord. Unë mendoj që duhet të kemi mirëkuptim. Përshëndetje të gjithëve. Mendoj se reforma e vitit 2014 është e dështuar për arsye se shërbimet nuk ishin më pranë qytetarit, siç u premtua. Vendimmarrja nuk ishte më afër qytetarit, siç u premtua nga reforma e 2014-s. Gjithashtu, lidhur me investimet dhe problemet e tjera, pothuajse nuk pati asnjë ndryshim në efektet financiare, sepse administrata ishte po ajo. Mendoj që... Rekomandimi, ju lutem. Rekomandimi është që të qëndrojnë... të riktheheni komunave ose të qëndrojnë njësi të nivelit të dytë me kompetenca dhe jo të merruar nga kryetarët e bashkive. Pra, duhet të jenë njësi vendore me kryetarë të zgjedhur, me kompetenca dhe me përfaqësues të pushtetit vendor, si këshilltarë të zgjedhur, që vendimmarrja të mbetet e pushtetit sa më afër qytetarëve të pushtetit lokal. Faleminderit. Ju faleminderit. Po, zotëri. Thjesht për shqetësimin. Ju faleminderit. Mora kohen.

Luan Merxhani:

Përshëndetje të gjithëve. Jam Luan Merxhani, mësues prej shtatë vjetëve në pension. Ëh, do ta filloj nga reforma administrative, duke u mbështetur te katër fabula. E para, kur isha në Greqi, punova tek një... Zotëria atje më thotë: "Nga je?" "Nga Delvina." Thotë: "Më thotë kam shumë qejf ta shikoj Delvinën, sepse babai im ishte tregtar dhe të gjitha prodhimet bujqësore i merrte në Delvinë. Po të vesh sot në Sarandë, të gjithë... të gjitha prodhimet bujqësore, pothuaj jo të gjitha, vijnë nga zona e Delvinës. Mirëpo, drejtoria bujqësore nuk është në Delvinë, është në Sarandë. Prandaj kërkohet që drejtoria e bujqësisë t'i kthehet Delvinës, plus të tjera." Ai zotëria atje, nga bashkia e bregdetit, ma merr mendja e Himarës, tha që fshati është në bashkinë e Himarës, ndërsa tokat i

administron Delvina. Është e vërtetë se po të nisemi nga Evlia Çelepia, në vitin 1600, Delvina ka qenë Sanxhak dhe administronte që nga Borshi, edhe Kuçin, deri në Kardik të Gjirokastrës. Unë nuk jam për zgjerimin e bashkisë, po të qëndrojë bashkia e Delvinës, të qëndrojë me ndonjë zgjerim të vogël. Ëh, se bashkia e Finiqit na ka ardhur mua mbi Delvinë. **Mbi le** kërkojnë edhe ëh taksat e **pushit të naftës**. T'i marrin në... t'i marrin bashkia e... e kur ajo faktikisht është në territorin e Delvinës dhe të gjitha kullotat në fshatin Kardikaq i kanë blektorët e zonës së Delvinës. E dyta, pse duhet të qëndrojë bashkia e Delvinës? Ëh, përgëzoj dhe përshëndes iniciativën e qeverisë që Delvina u shpall zonë kulturore arkitektonike. Mirëpo, këto fonde, ju lutem, mos ja çoni Sarandës për t'i administruar, sepse në Sarandë ka det dhe dallgët e detit mund t'i marrin këto fonde dhe t'i humbasin fare. Lejani Delvinës. E dyta, e treta, pse duhet të qëndrojë bashkia e Delvinës? Sepse në bashkinë e Delvinës ka shumë të moshuar dhe është shumë e vështirë të vijë të marrin... ta marrin shërbimin në Sarandë. Tjetër që doja të të shtoja, duke u nisur nga një aspekt, një miku tim kishte një problem dermatologjik. Në Sarandë nuk ka dermatologë dhe duke përshëndetur prapë qeveritë. Qeveritë që e shkurtuan rrugën nga Delvina në Gjirokastrë, ne shkuam në Gjirokastrë. Mirë thotë ai dermatologu: "Jo," thotë, "ju e keni qendrën në Vlorë. Ne i duam vlonjatët. I duam, e kemi xhan." Mirëpo, është shumë larg, po i thonë tre orë, ndërsa Delvinë-Gjirokastrë 45 minuta, 45 minuta, një orë e gjysmë. Këtu na duhen tre orë dhe tre orë, gjashtë orë. Prandaj e duam bashkinë e Delvinës. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Po, ëh, dhe pastaj do të jenë dy zonja, zonja Dhimojani dhe Keti, dy zonja. Faleminderit. Po, zotëri.

Unknown (nuk u prezantua):

Faleminderit të gjithëve. Pas shumë përpjekjeve, e mora fjalën. Si duket, opozita duhet të bëjë gjithmonë luftë për të arritur ato që duhet të arrijë. Gjithsesi, ëh, fjala ime ka të bëjë vetëm me dy aspekte. Aspekti i parë, ëh, qëndron në fjalën që bëri ë ministri. Nuk kuptova që kishte ndonjë problem në këtë situatë që është krijuar, se në qoftë se nuk kishte asnjë problem, s'kemi pse të jemi në këtë sallë. Pra, ëh, duhet të identifikojmë mirë që kemi një problem dhe mbasi të identifikojmë që kemi një problem me reformën territoriale të bërë në vitin 2014, në mënyrë të njëanshme, ëh, thellësisht politike, thellësisht politike, sepse në të kundërt, në qoftë se do të ishte thellësisht politike, do të ishin marrë sot vetëm me të korrigjuar aspektet veçanta të asaj reforme dhe jo bërjen e një reforme të re nga e para. Ëh, reforma e bërë në 2014, për nga mënyra, për nga përmbajtja, për nga territori, për nga forma, për nga çdo gjë, është bërë me një qëllim të vetëm: për të marrë vota në interes politik të Partisë Socialiste, e cila me atë reformë arriti që të marrë pushtetin nëpërmjet përdorimit të bashkive të krijuara me qëllim mbajtjen e pushtetit, siç po e mban edhe sot. Me këtë e mbylla. Faleminderit. Sepse kjo është një gjë. Jo, e mbylla këtë pjesë. Faleminderit. Se nuk kam ndërmend ta mbyll. E dyta, se e kam dalur dy herë. E dyta, po të të të të qëndrojmë te te ndarja territoriale. Ëh, po t'i referohemi bashkisë Vlorë. Bashkia e Vlorës ka një territor i cili, në ndarjen e 2014-s, ka të përfshirë disa komuna të cilat janë shkrirë në atë periudhë dhe që ka të bëjë me komunën në qendër, komunën Shushicë dhe komunën Novosel. Asnjëra prej

tyre nuk ka asnjë lidhje organike me qytetin e Vlorës. Orikumi gjithashtu është shkrirë në mënyrë të palishme. Një bashki e cila të bien të gjithë dakord, të gjitha palët bien dakord, të gjithë kur ulesh në kafe, të gjithë flasin dhe bien dakord që Orikumi duhet të jetë bashki dhe Orikumi duhet të jetë bashki. Ëh, ëh, ndërkohë, po jo, faleminderit se kam një orë. Tre herë e kam dalë pa ëh, ndërkohë, për sa i përket, për sa i përket, për sa i përket Novoselës, ajo që mund të them është që një pjesë e fshatrave të cilat janë rreth, të paktën në mendimin tim modest, që janë rreth qytetit të Vlorës, pra po flas për Kaninën, po flas për Nartën, të cilat kanë një lidhje babicën që kanë një lidhje organike me qytetin e Vlorës, mund të jenë pjesë e bashkisë së Vlorës, por nuk mund të jenë pjesë e bashkisë së Vlorës, ëh, Llakatundi dhe të gjitha fshatrat e rreth e rrotull, të cilat mund dhe të bashkohen së bashku me Novoselën për të krijuar një njësi e cila mund të jetë një bashki më vete. Ëh, ndërkohë, dhe e fundit, ëh, ajo që është akoma dhe më e paqartë dhe që e duket, duket që reforma e 2014-s është skandaloze, ka të bëjë me bashkimin e fshatrave të Horvranishtit, Kuçit dhe disa fshatrave të tjera me bashkinë e Himarës. Pa asnjë lidhje me njëra-tjetrën. Po çka, çka do të thotë pa asnjë lidhje në kuptim të shërbimeve, sepse qëllimi. E nderuar, po, ju lutem, ju lutem, fokusohuni tek mesazhi. Duhet ta përmendim. Mesazhi është ky: që reforma bëhet për ta vajtur te qytetari. Ndërkohë, reforma ka ikur nga qytetari, ka shkuar te qeveritari. Kjo është logjika dhe nuk ka, nuk ka kuptim që bashkia e Himarës, që duhet të jetë një bashki me një shtrirje përgjatë bregdetit, pra me Lukovën, të shkojë dhe të vejë në Kuç. Dhe kjo duket qartësisht që është politike. Nuk ka lidhje fare me asnjë shtrirje. Do duhet të fokusohemi tek rekomandimi. Më thuaj çfarë kontributi mund të ketë bashkia. Mund një fjali, një fjali. Po tani, unë ëh, është e katërta herë një fjali. Ju lutem, përmbylleni. Jo, e kam dalur tre herë. Keni mbaruar. Një sekondë, se nuk dua të krijoj konfuzion. Tani ajo e fundit që dua të them unë, e fundit që dua të them është: më duket se na keni mbledhur kot. Këta, të paktën, na kanë mbledhur kot, se më duket se këta ky nuk është. Se po të qeset për të mbledhur tamam, tamam, duhet të veni të shkoni të përgjitha këto njësi të administrative, ta kuptoni realisht se çfarë shërbimesh kanë marrë këto 10 vitet e fundit dhe pastaj të flisni. Ndryshe nga sa po flisni sot.

Valbona Karakaci:

Keti, Keti dhe zonja Dhimojani. Po, si jo? Zonja Dhimojani. Ju lutem, çfarë bashkie nuk është? Cila është bashkia që nuk është përfaqësuar? Po, më jep fjalën. Do ju japim patjetër fjalën. Dy zonja dhe pastaj juve. Dy zonja dhe pastaj juve. Ju lutem, Keti dhe zonja Dhimojani.

Afrovita Dhimojani:

Unë quhem Afrovita Dhimojani. Jam këshilltare në këshillin bashkiak të Himarës nga grupi i Partisë Demokratike. Në fakt, do ishte shumë mirë, sepse e kanë thënë dhe parafolësit më përpara, që këto dëgjesa do ishin shumë mirë të kishin ndodhur në çdo njësi më vete dhe jo vetëm dëgjesë në rang qarku, sepse në çdo njësi do dëgjohej edhe më qartë zëri i qytetarëve. Himara e ka kundërshtuar në 2014 reformën territoriale, sepse në fakt të gjithë që e njohin Himarën e dinë që ajo që është bërë me Himarën në 2014 nuk quhet reformë territoriale ekonomike që ka të bëjë me shërbimin, funksionalitetin, por është e qartë një reformë politike. Neve sot përsëri duam të ngrejmë

zërin tonë edhe të dëgjohe mi, duke e bërë të qartë që ajo reformë është e dështuar, sepse duket qartazi në shërbimet, në shërbimet e munguara. Dhe unë nuk e di sepse zoti Mazdiku e tha në fillim të fjalës së vet që në 2014 reforma territoriale solli edhe kompetenca më shumë bashkive. Unë, të paktën nga eksperiencia time në këshillin bashkiak, shoh që bashkia më tepër ka kompetenca formale sesa kompetenca reale. Të paktën në zonën e bashkisë së Himarës, lejet zhvillimore, ëh, bashkia e Himarës ka të drejtë që t'i japi vetëm lejet me sipërfaqe shumë të vogla, se ato kërkohen te ASHT-ja lartë. Ëh, mund të them si anëtar e këshillit bashkiak, plani i përgjithshëm vendor që ne pritët ta votojmë, ta miratojmë së shpejti në këshillin bashkiak, vjen në këshillin bashkiak të Himarës, po vjen formalisht, sepse realisht ai ë i granohet, studiohet, bëhet tek institucionet qendrore. Ujësjiellësi, një ndër shërbimet që këshilli bashkiak i Himarës e ka votuar në unanimitet pozitivë dhe opozitivë kundër që të bashkohet me ujësjiellësin e Vlorës dhe të Selenicës, sepse neve kemi pasur një ujësjiellës me menaxhim dhe shërbim shumë të mirë, nuk e kemi pasur me borxhe dhe është bashkuar me dy ujësjiellësa të tjerë që sot, në fakt, qytetarët e bashkisë së Himarës, kur kanë një problem me ujësjiellësin, janë të detyruar të vijnë në qytetin e Vlorës. Edhe ato institucione që janë aty nuk funksionojnë. Edhe një gjë të fundit: në qoftë se ne do themi bashkia e Himarës, çështja kryesore është çështja e pronave. Çështja e pronave kërkon vullnet politik real për t'u zgjidhur. Të iki kadastra e nga Vlora dhe të iki në Tiranë dhe ju të thoni që çdo aplikim sot bëhet në sistem online, ku ne e dimë shumë mirë që i Albania në shumicën e rasteve nuk funksionon dhe kur funksionon, sjell përgjigje formale. Në Himarë është premtuar disa herë që do sillet kadastra, do sillet ë zyra e aluizmit me specialistë për të zgjidhur çështjen e pronave. Faleminderit shumë.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Lutem, Keti dhe pastaj zotëria. Keti, pastaj zotëria, dhe ma ka kërkuar disa herë fjalën zoti Tavo. Pas zotërisë, zoti Tavo. Okej, përshëndetje.

Alketa Dhimitri:

Unë jam Alketa. Jam aktiviste e shoqërisë civile. Sot jam këtu si përfaqësuese e rrjetit Përballja e Ofertave Politike, një grupim organizatash që monitorojnë punën e bashkive në territore të ndryshme në gjithë Shqipërinë. Atëherë, në kuadër të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative Territoriale, grupimi ynë ka përgatitur një dokument politikash që do të kërkonim t'ia u paraqisnim deputetëve të këtij komisioni, por edhe deputetëve në përgjithësi. Ëh, disa prej rekomandimeve tona që kjo reformë duhet të adresojë janë si më poshtë: reforma duhet të rikthejë afërsinë midis qytetarëve dhe qeverisë vendore. Konsolidimi territorial ka rritur kapacitetet administrative në disa raste, por në disa zona të tjera, sidomos rurale dhe periferike, qytetarët ndihen më pak të përfaqësuar. Reforma duhet të rikthejë aftësinë midis ë mundësive që paraqiten për të bashkëpunuar, për të fuqizuar bashkëpunimin midis njësive administrative dhe qytetarëve. Duhet të gjendet një mekanizëm se si këta qytetarë që vijnë nga njësi më të vogla, që janë njësi administrative, të përfaqësohen në bashkitë e mëdhaja, në bashkinë e madhe. Gjithashtu, reforma duhet të adresojë pabarazitë territoriale dhe sociale si prioritet politik. Ne eidentojmë diferenca shumë të mëdha të shpërndarjes së investimeve dhe në nivel të shërbimeve brenda të njëjtës

njësi territoriale, njësi bashkiake. Këto pabarazi rrisin ndjesinë e marginalizimit dhe çënojnë besimin ndaj institucioneve, veçanërisht në komunitete periferike. Reforma duhet të vendosë mekanizma detyrues për shpërndarje të balancuar territoriale të investimeve, në transparencë të plotë mbi alokimet dhe prioritizimin e bazuar në analiza të nevojave territoriale, sociale dhe gjinore. Së treti, cilësia dhe barazia në shërbime është tregues kryesor i suksesit. Nëse duam një reformë që të funksionojë, qytetarët e masin reformën nga shërbimet që marrin, sa të aksesueshme janë këto shërbime, sa cilësore dhe sa të barabarta. Për ne, mendojmë që reforma duhet të vendosë standarde minimale kombëtare për shërbimet vendore dhe për sisteme të rregullta për matjen e performancës dhe kënaqësisë së qytetarëve ndaj shërbimeve që marrin nga bashkitë e tyre, me të dhëna të ndara sipas territorit dhe kur është e mundur sipas grupeve të popullsisë. Planifikimi dhe financimi duhet të lidhen me performancën dhe barazinë në akses për shërbime. Transparenca dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje ekziston në letër, ka ligje shumë të mira, por në realitet realizimi i saj mbetet ende hapa larg nga ato që kemi në ligje. Duhet përmirësuar ose duhen vendosur mekanizma të cilat e shtrëngojnë këtë. Dhe së fundmi, ndryshimet territoriale kërkojnë legjitimitet të fortë demokratik në ato raste kur do të ndodhin ndryshime kufish midis bashkive të ndryshme, ku ë kërkohet realisht marrja e mendimit qytetar. Në vende ku disa bashki bashkohen, është shumë e rëndësishme që qytetarët të dëgjohen dhe të merret parasysh vendimi i tyre. Ju falenderoj.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, zotëria. Pastaj zoti Tavo dhe Vilma. Ëh, dhe dikush nga bota akademike gjithashtu.

Unknown (nuk u prezantua):

Po, përshëndetje. Në radhë të parë, kërkoj ndjesë për ngritjen e tonit. I nderuar zoti Mazniku, zoti Boçi, unë jam arsimtar, por njëkohësisht edhe fermer i nxarës së bashkisë së Konispolit, i nxarës së agrumeve, e cila është ikona jonë, është mbretëresha jonë, mandarina jonë, e cila gjeneron rreth 35 deri në 40 milion euro për bashkinë e Konispolit. Që do të thotë kjo: dua të jap shembullin se si një bashki rurale mundet dhe ia del. Kemi sot, aktualisht, meqënëse jam dhe arsimtar, të gjitha shkollat të rikonstruara me ngrohje, me palestra dhe kushtet shumë të mira për zhvillimin e arsimit, njëkohësisht edhe kopshteve të fëmijëve. E dyta, kanalet pastruese vaditëse, të pastruara totalisht, kanale rrugë, rrugë të cilat jemi për reformë territoriale. Të lutem, të lutem, të lutem shumë, po jap, po jap modelin, po jap modelin se si bashkia, si bashkia rurale funksionon. Prandaj jemi këtu që të japim mendimet tona. Bashkia rurale e Konispolit është bashkia e cila është shembull në Shqipëri, është shembull se si duhet të trajtohet dhe si duhet të marrin për të gjitha bashkitë e tjera. Prandaj jemi këtu. Ne jemi aty një Evropë e vogël. Nuk kemi ndasi, nuk kemi ndasi fetare. Kemi një bashkëjetesë harmonike shumë të mirë, edhe sepse historia ka treguar që Konispoli ka patur dorën e vetë në kombin shqiptar. Dhe tjetra që dua të theksoj më fort: duhet që të afrojmë shërbimin me qytetarin, shërbim dinjitoz, kur jemi më afër. Dhe unë jam që bashkitë rurale duhet të ekzistojnë dhe të vazhdojnë të ekzistojnë, sepse sjellin të ardhura, agroturizëm, ekonomi, bujqësi dhe blegtori. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Po, zoti Tavo.

Vangjel Tavo:

Përshëndetje. Si bashkisë i Himares dhe qytetari i Himares, pavarësisht se jam qytetari i parë i Himares si zgjedhur. Ëh, unë kam qenë pjesë e reformës zgjedhore në parlament në '14. Nuk e kam votuar reformën, edhe pse isha pjesë e koalicionit qeveritar, për arsye se ëh, sensibilitetet lokale më krijuan idenë që unë duhet të mbaja atë qëndrim. Dhe ë, po këmbëngul në këtë pikë që edhe në këtë reformë administrative, ë, parimi i ruajtjes së sensibiliteve, pra i respektimit të sensibiliteve lokale, duhet të ekzistojë duke respektuar historinë, identitetin dhe kështu me radhë. Ëh, patjetër që të bërit një reformë nga ana e deputetëve, nga ana e parlamentit, duhet të respektojë disa kriterë. E para njëherë, ë, është ë, kompetencat. Nuk mund të imagjinosh një reformë pa e bashkëlidhur këtë me kompetencat që duhet të ketë pushteti vendor. Nga ana tjetër, duhet që t'u ofrojmë, të kemi kapacitetet, pra njësitë administrative të bashkive dhe vetë bashkitë duhet të kenë patjetër kapacitetet njerëzore për t'u shërbyer dhe për të dhënë, për të ofruar shërbimin ndaj qytetarëve. Ëh, njësitë duhet të kenë patjetër topografin, është shumë e rëndësishme. Duhet të kenë patjetër juristin. Duhet të kenë patjetër shërbimin, ato që janë rurale, shërbimin e bujqësisë dhe të pyjeve. Pra, kapacitetet duhet të jenë një nga kriteret që duhen respektuar, duhen patur parasysh për ndarjen e re administrative. Dhe ajo që është më kryesorja, mendoj unë, është patjetër autonomia financiare. Ëh, për sa i përket dy çështjeve të para, mendoj se ë, ligji i pushtetit vendor që funksionon në Kosovë duhet të ketë parasysh kur do të flitet për kompetencat që duhet kjo reformë t'i bashkangjisi bashkive, pra t'i japi bashkive. Për sa i përket ë, autonomisë financiare, për mua është shumë e rëndësishme. Marr për shembull bashkinë e Himarës. Do ju sjell dy-tre shembuj. E para, nëse do të vazhdonte të ishte bashkia e marrës, ë, pra një nga njësitë, qoftë Lukova, qoftë Horë Vranishti, të ndara nga bashkia e marrës, investimet që po kryhen në '25-n dhe të parashikuar në '26-n për njësinë Horë Vranisht, me të ardhurat që kishte kjo si ish-komunë, i duhen 555 vite për t'i realizuar. Ndërkohë, po, po, merreni si të doni, po është kështu realisht. I kam statistikat këtu. Ndërkohë, ndërkohë, ndërkohë, edhe me grantin e qeverisë i duhen 200 vite për ato investime që po bën bashkia e marrës. Tjetra, po është e vërtetë. Po, tjetra, e njëjta gjë, e njëjta gjë për të bërë në njësinë e Lukovës, vetëm pa leje investimet e tjera që po bëjmë, vetëm ftera që foli zotëria dhe Çoraj, duhen të paktën 55 vite për njësinë e për ish-komunën e Lukovës. Pra, është shumë, shumë e rëndësishme. Tani, patjetër që duhet, po e mbyll, patjetër që duhet të ketë parasysh çdo reformë. E para njëherë, analiza a i ka shërbyer qytetarëve dhe a ndihen qytetarët më mirë apo jo. Dhe unë mendoj që po, reforma administrative i ka shërbyer qytetarëve dhe këtë e them me bindje, sepse e marr për shembull bashkinë e Himarës. Nga ana tjetër, te kompetencat, nuk mund të imagjinojmë një bashki pa patur kompetencat të shërbimit shëndetësor, të shërbimit arsimor, të ujësjellësit, të kanalizimeve, dhe pse jo, meqë jemi në Vlorë dhe që problemi kryesor i Vlorës dhe i marrës janë pronat, pse jo, dhe çështjen e legalizimit, patjetër që duhet të kryhet në bashkinë përkatëse, pra të kenë kompetencë.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Vilma dhe pastaj Alta. Vilma dhe pastaj Alta. Po, Vilma Alta. Po, shumë faleminderit.

Vilma Bello:

Vilma Bello nga bota akademike. Ju lutem, Vilma Alta. Ëh, prej botës akademike, ë, besoj që arsyeja sepse komisioni i posaçëm për reformën territoriale ka zbritur nëpër zona është patjetër e para, në dijen time dhe në atë që unë njoh, është sepse patjetër përafriimi me legjislacionin europian ka një pjesë shumë të madhe të përafriimit të legjislacionit në një masë shumë të madhe gati 70%, dhe kjo është një arsye që na ka nxitur të hyjmë në një rishikim të reformës administrativo-territoriale. E dyta, si çdo reformë administrativo-territoriale, patjetër që si çdo reformë ka progreset e veta, ka paqartësitë e veta, dhe në çdo moment të miratimit të një reforme ka patur patjetër që jo vetëm progres në disa elemente, por sot nuk jemi mbledhur për të thënë se çfarë progresi kishte, se sa ndoshta jemi mbledhur më së shumti akoma për të thënë se çfarë do bëjmë me reformën që do miratojmë më pas. E përshëndes shumë të gjithë komunikimin që bën sot qytetarët, edhe kushdo nga ne që kemi qenë apo jo me funksione politike në radhë të parë jemi qytetarë, dhe pjesa më e madhe këtu jemi e duam përkatësinë tonë, dhe prandaj edhe marrim nganjëherë edhe zjarr edhe për të folur. Por shumë nga gjërat u thanë, biles unë isha shumë dakord me dy nga pikat që tha kryetari Tavo, edhe me një nga pikat që tha Ketii, dhe do të ndalesha vetëm në dy të tjera që të mos i përsëritja. Ëh, e para, që të bëhet rishikimi i reformës territoriale, administrativo-territoriale, nuk mund të nisemi as nga ana politike dhe as nga asnjë gjë tjetër përveçse nga funksionaliteti dhe cilësia e shërbimeve. Që do të thotë, reforma administrativo-territoriale nuk është qëllim në vetvete, dhe nuk besoj që ndarja e kufijve është këtu qëllim në vetvete për të thënë cila është kjo bashki, cila është kjo bashki tjetër, sa territor ka njëra dhe sa territor ka tjetra, sepse mbi të gjitha triumfon shërbimi ndaj qytetarëve, shërbimi dhe cilësia e shërbimit. Tek cilësia e shërbimit, që në fillim kur e nisëm takimin, e thamë që pjesa më e madhe e problematikave janë në bashkitë. Bashkive vërtetë u është dhënë një pjesë shumë e madhe e kompetencave, por nëse këto kompetenca nuk kanë kufi të qartë për të dalluar mes kompetencave që ka pushteti vendor dhe pushteti qendror, shpesh herë ato ngatërrohen, dhe kur ngatërrohen, askush pastaj nuk e ushtron siç duhet pjesën e vet të ushtrimit të kompetencës, dhe kjo lidhet patjetër jo vetëm pastaj me cilësinë e shërbimit, por lidhet padyshim edhe me autonominë financiare të çdo bashkie. Nëse i jepet një grant ose një transfer të caktuar bashkie, dhe duhet të rritet autonomia duke ju lënë hapësira që njësitë vendore, bashkitë, në çfarëdo lloj territori që do të përcaktohen, të kenë mundësitë për të përfituar fonde nga projekte dhe të mund t'i ushtrorjnë kompetencat që pushteti qendror ja jep, por t'ia japë dhe t'ia lërë të pavarura, duke i bërë të mundur që edhe bashkitë të fitojnë autonominë e tyre. Referuar asaj që thashë që në fillim, e kemi dhe detyrim të Acquis edhe të procesit të Bashkimit Europian për të hyrë në Europë, për të përafuar legjislacionin dhe për t'i dhënë më shumë pushtet bashkive. Faleminderit.

Alta Azizi Aluci:

Unë jam Alta Azizi Aluci, jam pedagoge në Vlorë, por jam anëtare e këshillit bashkiak, përfaqësuese e Partisë Demokratike. Një nga pikat kryesore tona janë që të kthehen

bashkitë një pjesë e bashkive të rëndësishme, dhe prandaj përfaqësuesi i Orikumit do flasë dhe jam shumë e kënaqur t'ia kaloj fjalën atij. Faleminderit.

Sheme Kondi:

Përshëndetje. Unë jam Sheme Kondi, biznesmen në Orikum. Jam nga Dukati. Aty kam lindur, këtu jam rritur, atje e kam edhe aktivitetin. Aty kam qenë edhe i zgjedhur vendor një kohë tjetër, atëherë vitet '90, i drejtoja bashkinë e parë të Orikumit. Ëh, unë them kjo nuk po bëj ekspertin këtu për të gjithë reformës e gjithë kompetencave të pushtetit lokal. Nuk më interesojnë shumë tani, por ne kemi qenë viktimë e parë ose viktima më e madhe ose preja më e madhe e kësaj reforme që është bërë, sepse shikojmë pasojat çfarë ka ndodhur mbas kësaj me Orikumin, me Dukatin, me Tragjasin, me Radhimën, me Orikumin. Ëh, për nga territori dhe nga resurset është vështirë të të krahasosh as me Himarën, me shtatë fshatrat, as me Selenizën, kur kemi brenda Gadishullin e Karaburunit, detin e Adriatikut, detin Jon, parkun e Llogorase, parkun kombëtar Karaburun-Sazan, Tragjasin, Radhimën. Janë të Dukatit, zotëri. Janë të Dukatit, pavarësisht që tani ja bërë, jo, jo, përpara se të jenë Shqipërisë, përpara se të jenë Shqipërisë, janë Dukatit. Ne e kemi mbrojtur Dukatin nga qafe e Llogorajit dhe kudo nëpër gjithë Shqipërinë. Kemi lënë, e kemi, kemi mbajtur krahët të qeverisë së Vlorës dhe gjithë, dhe gjithë shtetit shqiptar. Po, ore tani nuk kemi në diskutim tani. E brenda, brenda territorit tonë ishte e vetmja marinë turistike në Shqipëri, marinë e Orikumit, investim i realizuar në vitet '90, baza ushtarake, kantieri detar. Ëh, duhet të dini që ekonomia e Orikumit, përveç turizmit, përveç turizmit që është i zhvilluar shumë në Orikum, në Llogora dhe në Radhim, është prodhuesja më e madhe e peshkut të akuakulturës. Në njësinë e Orikumit, ë, kompanitë vendase prodhojnë 10.000 ton peshk dhe pjesa më e madhe shkon për eksport dhe përfaqëson Shqipërinë. Unë them që kjo reformë, këto ndryshime duhet të rikthejnë bashkinë. Duhet të rikthejnë bashkinë e Orikumit. Ka qenë komunë në vitet e Zogut, ka qenë njësi, na ka ndarë natyra, na ka ndarë Zoti, na ka dhënë det, na ka dhënë lumë, na ka dhënë burime, pavarësisht se të gjitha këto burime tani ju duhen të tjerëve për të rregulluar bashkitë e tyre, për t'i, për të rregulluar ato egot e tyre dhe pasuritë e tyre. Të gjitha këto janë në kurrizin tonë. Po të ishte bashki, nuk do na i vidhnit, dhe vjedhja vazhdon, po themi, po vazhdon me hapa të mëdha. Turizmi që po zhvillohet në Radhim është i paqëndrueshëm. Është një turizëm i paqëndrueshëm. Ndërtohen pallate, ndërtohen hyrje pa fund në Orikum, në Radhim, dhe janë shkatërruar, janë prerë me mijëra ullinj shekullorë, limona, portokalle, pa ekuilibër, pa qëndrueshmëri. Ne nuk jemi dakord kështu. Ne duam një bashki që të paktën, o të paktën, të marrim vulën, se aty ka mbaruar çdo gjë. Kallës do mbledhim ne. Kështu që na ktheni bashkinë, edhe kjo pastaj dinë vetë, i kemi vetë resurset siç i kemi patur. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Po, zotëria nga Saranda, ju lutem. Se është zotëria. Jo, ju lutem, zotëria. Jo, zotëria nga Saranda, se vërtetë ka kohë që. Faleminderit për durimin. Faleminderit shumë.

Unknown (nuk u prezantua):

Faleminderit shumë. Ndoshta jemi pozicionuar këtu nga krahu i majtë dhe nuk do të thotë që jemi, nuk kemi sugjerime, kritika ose ndoshta, ndoshta dhe ideja. Ëh, për fat të mirë, paskam dhe të djathtë këtu në krah. Tani, ë, shumica nga ne ose pothuajse të gjithë kuptojmë që këtu është e ardhmja e fëmijëve tanë. Me të gjitha këto vendimmarrje ose të gjitha këto sugjerime që ne do japim, në një të ardhme ju do jeni ata që, dhe ata që janë nga mbrapa, do jenë në pjesë e vendimmarrjeve shumë, shumë pozitive ose do ketë dhe negativitete në vendimmarrje nga ë, paneli që drejtojmë. Por çfarë ndodh? Mirë ishte që ë, të kishte ekspertë për të gjitha fushat, kush flet, dhe të japë disa sugjerime nga ë, nga ajo, nga ajo fushë që gjithsecili zotëron. Për arsye se ne ë, këtu në bashkitë që ë, për shembull, Sarandën, ne jemi, ne jemi qytet që duhet të kemi më shumë vendimmarrje vetë. Duhet të kemi më shumë ë, ë, punë të kryera me, domethënë, gjithsecili e di vetë se ku i pikon çatia dhe vendimmarrjet ë, nuk, nuk duhet të presim, për shembull, menaxhimin e plazheve. Të vijë nga ë, dikush që nuk është ë, afër gjësë që ta prekë gjënë, që të shikojë se si funksionon plazhi, si funksionon ë, problematika e një qyteti. Domethënë, duhet të jemi, duhet të jemi më me shumë ë, lëshim kompetencash ë, që nga kreu i bashkisë, nga kryetari i bashkisë dhe deri tek ë, ata që menaxhojnë drejtori, drejtor, zinxhiri i drejtorive. Kjo, kjo sjell pozitivitet në shumë aspekte. Dhe ë, në Kosovë, për shembull, që të vijë një shef komisarati në një qytet, duhet të marrë pëlqimi, dhe 90% e vendimmarrjes është kryetari i bashkisë. Nuk mund të vijë një shef komisarati. Ndoshta nuk dua që të e kuptoni se nuk themi se duhet të kemi probleme që ta themi këtë, por ju e dini shumë mirë se si funksionon gjëja, zoti Masniku. Ne kemi, domethënë, një familje. E di Zoti shtëpisë se ku i pikon çatia, që do të thotë që nga fillimi deri në fund, dhe ai katërvjeçari i mandatit të një kryetari të bashkie do jetë pastaj përfundimi që i do jetë pozitiv apo do jetë ë, që nuk populli e vendos në qoftë se ai do jetë një person që nuk do ketë bërë punën e që i takon. Prandaj, kompetencat duhet të lëshuar sa më shumë. Jo t'i tërhiqni. Unë kam pothuajse tetë vjet në bashkinë e Sarandës që nuk ka vit që mos të hiqen kompetencat. Jo bashkë, më falë, jo bashkia e Sarandës, në të gjithë territorin e ë, republikës së Shqipërisë, për bashkitë. Domethënë, nga momenti që ne duhet t'i shtojmë kompetencat, se ne vërtetë tek ai ndryshimi që thamë i 2014-s ka prurë pozitivitet, ka sjellë të ardhura të cilat sot investohen, dhe parafolësit, kolegët e mi që i dua shumë dhe nuk i kam kundërshtuar asnjëherë në këshillë, duan që Ksamilli të jetë në bashkinë vete. Për arsye, ndoshta këtu nuk ka politikë. Ksamilli sot lulëzon. Ksamilli sot ka investimet që nuk i ka patur në 34 vjet. Prandaj, të themi të mirat, por të themi dhe negativitetet. Tani, ne themi që kompetencat e kryetarit të bashkisë sot janë pothuajse gjysma e para 10 vjetëve. Ëh, unë thosha që ngaqë e prek gjënë dhe e shikoj, duhet sa më shumë kompetenca bashkisë, sa më shumë kompetenca ë, që kur nga momenti që fillon një punë ta çojë deri në fund dhe të dijë vetë se si ta menaxhojë. Domethënë, plazhin është shumë kryesor, një nga problematikat kryesore që unë po e përmend tre herë, që mënyra se si funksionon, se unë nuk kam lidhje me plazhet, e ta dinë, se mos e quani se mos ka të bëjë me pjesën individuale. E kupton? E di vetë bashkia se si funksionon ndërtimi, e di vetë komisarati, e di vetë kryetari i bashkisë se ku cënon, ku është problemi. Prandaj, duhet edhe të marrë, kemi shembull Kosovën për këto që unë po ju ë fola. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, zotëri atje, dhe pastaj zoti Balili.

Bezet Mamutaj:

Bezet Mamutaj, kryeplak i fshatit Treblovë, bashkia e Selenicës. Një gjë thelbësore dua të them: meraku dhe nepsi dhe përpjekja e politikës dhe të dy krahëve që neve na drejton dhe na udhëheq është për t'i qenë popullit sa më afër shërbimi i bashkive, i njëjstëve, i të gjithëve këtyre. E për të qenë sa më afër, kjo nuk do të thotë që të delendiset populli nga 50 km ku është fundi i bashkisë së Selenicës në Shkozë dhe të vijë të zgjidhë hallin tek Bruna në Vlorë. Të më fal, Bruna, sot është Bruna, nesër do vijë Bruni tjetër, apo sot është Nertili në Selenicë, nesër do vijë në Ardia dikush tjetër. Është e rëndësishme shërbimi të shkojë tek qytetari. Ju lutem, ju përfaqësuesit kryesorë të këtij komisioni, në fund do keni urimin dhe bekimin ose mallkimin e asaj pjese të kësaj bashkie. Nëse nuk i përgjigjeni që ne të mos delendisemi dhe të mos marrim sokakët e Vlorës për shërbimet minimale tona, ajo bashki nuk është aq sa është kazandisur sot, aq popull sa ka dhe votues, si të doni quheni. Ajo bashki i shërben dhe pjesës së popullatës së emigruar, se problemet ata vijnë e i zgjidhin aty ku jemi neve dhe nuk vijnë as në Vlorë, as në Tiranë. Ju lutem, kur bëni ato, kalkuloni ato letrat dhe numrat. Nuk di nga kjo pjesë. Llogariteni dhe atë pjesë. Ajo është e jona. Ata që kanë ikur andej, është e jona. Një vretje kam të vogël. Të më fal, bashkia e Himares. Ujë tek kuçit e duan, po kuçit nuk e duan pjesën dhe vranishtin. U faleminderit. Suksese komisionit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit, zoti Balili, dhe pastaj zoti Basha. Po, po, ju lutem, Balili.

Sezai Balila:

Përshëndetje të gjithëve. Unë jam Sezai Balila. Isha administrator i njësisë administrative e Brataj i bashkisë së Selenicës 2015-2019. Ajo që thekson, e doja të thoja me zë të fortë, është që ne, ë, mandatin e parë 2015-2019, bashkia e Selenicës kishte 29.000 banorë për të votuar dhe votuan diku tek 11. Sot ka arritur gjysma. Kjo do të thotë përkthehet ndryshe që 40% e popullsisë së kësaj bashkie është larguar. Ëh, jo vetëm në këtë bashki, por në të gjithë bashkitë e vendit. Ky është një fenomen prezent edhe është i evidentuar nga të gjithë, ë, dhe besoj që biem dakord. Ajo që, ë, mua më shqetëson personalisht është tek bashkia e Selenicës. Ëh, ka fshatra që unë po të jetë e përmend edhe me emra, fshati i Bashaj i njësisë administrative e Brata që është një nga fshatrat më të largëta. Ëh, në periudhën e dimrit ka pasur një rrëshqitje të rrugës ku edhe sot, pavarësisht sepse nuk dua që të të abuzoj apo të spekuloj me ato, pavarësisht punës që ka bërë qeveria apo bashkia, ë, rruga nuk është hapur aty ku ka qenë edhe gjithë banorët e atij fshati. Ëh, ju duhet katërfishi i kohës për ta përshkruar këtë rrugë. Domethënë, kur ajo përshkruhet për 10 minuta, tani do 40 minuta apo 45 minuta. Po kështu, të gjithë fshatrat e tjerë të asaj njësie kanë, duan minimalisht, ë, 60 minuta apo, ë, 120 minuta për të shkuar në qendrën e bashkisë. Po kështu, të gjithë njësitë administrative, duke përfshirë kotën, duke përfshirë vlahinë, duke përfshirë Sevasterin, duan nga dy orë për të shkuar në Selenicë. Kjo është vetëm për fajin e reformës administrative territoriale të 2014-2015-s. Kështu që mendimi im për ta përmbyllur është

që kjo bashki, ë, mendoj që nuk ka dhe asnjë lidhje organike me të gjithë këto ashtu, edhe territorin e ka jashtëzakonisht të madh. Mendoj që është më mirë që t'i shërbejë qytetarëve, qoftë për shërbime, qoftë për të gjitha nevojat e qytetarëve, të bëhen dy bashki: një me qendër në kot dhe një edhe bashkia e Selenicës që e ka qendrën e Selenicës. Është e padrejtë, sepse të gjithë qytetarët i bie 17 km nga Peshkopia të shkojnë dhe 17 vijnë, 34 km, domethënë janë kot, kur edhe qytetarët e Selenicës që tashmë janë të të kurrur 100%, domethënë janë kot. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit, zotëria, që e ka mikrofonin pak me...

Fuat Mati:

Mirëmbërëma. Meqënëse e kemi, quhem Fuat Mati, bashkia Himare. Pastaj, zotëri atje, po, Fuat Mati, bashkia Himare. Ajo që unë do të thosha ishte që mendoj se këtu jemi për reformën territoriale, jo për gara politike. Ne, si të djathtë dhe të majtë, kur vjen puna për të mbaruar hallet, i kemi të gjithë njësoj. Investimet na prekin prapë të gjithëve njësoj. Problemet na dalin prapë të gjithëve njësoj. Pse? Sepse ne nuk jemi individual, kemi familjet edhe fiset tona. Në bashkinë Himarë, unë mendoj se është gjetur territori dhe ndarja e duhur. Ka probleme, patjetër që ka. Ka disa probleme të vogla që janë tek teknike. Kur ka kaluar, ë, flas për shqetësimin që ngriti zoti Dhuli, kur ka kaluar, ish-komuna Lukovë nuk ka kaluar me të gjithë kapacitetet e saj të kullotave, edhe është krijuar një anë teknike e cila duhet parë nga komisioni për këtë problem. Për pjesën tjetër, për sa i përket kulturave, ne e jemi shumë në rregull, edhe unë nuk mund të flas për Selenicën apo për një për bashkinë e Fierit, por po flas për bashkinë e Himarës. Me sa di unë, Kuçi është ose zona Horë Vranisht që përmban pesë gjashtë fshatra, janë shumë në rregull. Ëh, investimet janë bërë edhe po vazhdojnë të bëhen shumë mirë. Mendoj se Bashkia Himarë duhet thjesht të ketë sa kompetenca më shumë. Për sa i përket mënyrës së menaxhimit nga ose bashkërendimit të pushtetit qendror me atë, me atë bashkiak, me atë vendor, është një gjë që nuk i përket, besoj, reformës territoriale, por i përket një stadi tjetër për ta diskutuar ju edhe ata të tjerë në parlament. Po ia kaloj fjalën këtij djalit të vogël këtu të flasë dikë.

Valbona Karakaci:

Ëh, okej, moderimi ka kaluar në sallë tani. Me c'shikoj. Ëh, në fakt, jemi jashtë çdo afati kohor. Unë i kërkoj dy bashkëkryetarëve, ju lutem, sido e bëjmë dhe dy fjalime dhe e mbyllim. Ëh, atëherë, dy ndërhyrjet e fundit, ju lutem. Ëh, unë ë, tani po zotëria atje që e ka mikrofonin dhe zotëria atje. Po, ju lutem. Po, pse çfarë t'ju them unë? Pas mua, Skadi.

Orges Basho:

Unë jam Orges Basho. Vij nga bashkia Delvinë. Njësia administrative Vergo. Jam dhe këshilltar pranë bashkisë Delvinë, subjekti i Partisë Social Demokrate. Tani, bashkia Delvinë, kur është bërë reforma e parë, i kanë dhënë një barrë shumë të madhe që i ka dhënë komunën e Vergojit, që ka qenë ku thërret qamet. Edhe ajo ka qenë një komunë shumë e varfër. Shumë iu dha një barrë. Pastaj, kryetarët, pavarësisht subjekteve

politike se ku kanë qenë, kanë mundur t'ia dalin të gjithë me radhë ndër vite. Shikojmë fshatrat që janë brenda për brenda me infrastrukturë, brenda fshatrave me asfalt, me beton, me shumë gjëra. Shikojmë ndryshime rrugore në fshatrat e zonës. Edhe faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ëh, më kërkojnë në fakt, për hir të së vërtetës, nuk do të kishte kuptim salla. Në fakt, njerëzit po lodhen, por nuk do të kishte kuptim që ta përmbyllnim këtë seancë pa dëgjuar edhe zërin e zotit Çuçi dhe zotit Dule.#. Okej, atëherë, zoti Dule apo Ina? Ina.

Ina Zhupa:

Në fakt, nuk e kisha në plan për të folur, por meqënëse folën kryetar bashkie, deputet, mendoj që edhe ne duhet të flasim. Më vjen mirë që të dyja palët, të gjithë qytetarët, pas një dallimi, pranuan që reforma territoriale është e dështuar dhe të gjitha, dhe të gjithë qytetarët kërkuan që shërbimet të afrohen afër tyre. Ajo që mua më vjen mirë është edhe fakti që duhet të kuptojmë që bashki të jenë funksionale, do duhet të kenë kompetenca. Në momentin kur punonjësit thonë që jemi punonjës nga Vlora dhe jemi të detyruar të shkojmë në Fier, jemi punonjës nga Vlora dhe jemi të detyruar të shkojmë në Tiranë për kadastrën, për shembull, që këtu ka marrë fund ajo që duhet të ishte shërbimi pranë qytetarëve. Dhe në bazë të reformës territoriale do të jetë funksionaliteti i bashkive, ku bashkitë të ofrojnë shërbime, ku institucionet të jenë pranë qytetarëve, dhe kur qytetarët nuk duhet të bëjnë kilometra të tëra për të marrë një shërbim, për të marrë një patentë, për të marrë një leje drejtimi e çdo gjë tjetër, do duhet t'i kenë afër tyre. Së dyti, në momentin që do të kuptojmë që pushteti qendror është i ndarë nga pushteti vendor, do të ishte një progres shumë i madh për bashkitë. Të gjithë kryetarët e bashkisë, pavarësisht se nuk e thonë dot, ishin të detyruar të detyronin drejtorët e tyre t'i jepnin dorëheqjen, siç ia kërkoi kryeministri, dhe u hap një portal: hidhni CV-të për vende pune, pa ditur se çfarë vende pune do keni. Në momentin që ndërhyhet kaq brutalisht në pushtetin vendor dhe kur kryeministri shkarkon drejtorët, i thotë: "Hiqni këtë dhe hiqni atë", dhe Vlora vetë vajti në zgjedhjet parakohshme, sepse ja u shkarkoi në një farë forme edhe ish-kryetaren e bashkisë, kuptojmë që kemi nevojë për kompetenca reale, për fuqi reale, për kryebashkiakë të cilët të jenë të mëveçëm nga qeveria, në kuptimin që t'i përgjigjen qytetarit më shumë sesa kryeministrit. Dhe e fundit, duhet parë raporti midis të punësuarve dhe asaj që jepet për shërbime. Kam planin e buxhetit të bashkisë Delvinë dhe ishte 240 milionë për paga, edhe vetëm 40 milionë për shërbime dhe për investime. Kjo është disbalancë e buxhetit. Prandaj, duhet parë me shumë vëmendje që kur të ndërtohet reforma, siç do të jemi të gjithë bashkë, të jetë një reformë që bashkitë i bën funksionale, kanë përfaqësim, sepse kështu nuk kanë përfaqësim. Tre bashkitë që kërkojnë, Oriqumi, Ksamilli dhe Amantja, nuk janë për numra, janë për funksionalitet. Janë që secili nga ato banorë atje të dëgjohet, të ketë përfaqësim në këshillin bashkiak, të ketë zë në bashki dhe t'i shkojnë taksat drejtpërdrejt atyre. Shumë faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit. Olti, ju lutem. Olti, dëshiron Çuçi? Po, ju lutem. Zoti Çuçi, Dule, Olti, dhe e mbyllim.

Bledi Cuci:

Se nuk doja të flisja, se merret edhe si konflikt interesi, por një sugjerim kam. Nuk dua të hyj fare te çfarë u tha këtu, se kam sugjerim edhe për komisionin. Këto debate duhet të paraprihen me një studim statistikor. Pra, mos flasim qesim, jo po 40.000, jo 40 milionë, jo tha Banka Botërore kështu, jo tha Banka Botërore kështu. Duhet që me referenca zyrtare të ekspertëve ndërkombëtarë, po të doni, të institucioneve ndërkombëtare, po të doni, duhet paraqitur, duhet bërë një përmbledhje, duhet thënë sa ka pasur buxhetin një komunë në vitin 2012 dhe sa e ka sot në brenda territorit të një bashkie të madhe. Sa e ka pasur gjithë bashkia e madhe, sa e ka pasur shumatorja e bashkive. Dhe, mbasi, t'i shohim ato statistika edhe të dhëna zyrtare. Mos flasim se këtu po duket si një orkestër që i bie veglave me vesh, edhe secili njëri lodh stallava, tjetri erbjën, erbjën kështu, ë, drogë, tjetri muzikë të lehtë, tjetri. Pra, këtu duhet bërë paraprakisht kjo gjë dhe pastaj hajde të diskutojmë. Jemi mirë, jemi keq, mund të shkojmë më mirë, mund të shkojmë më keq. A është pjesë performance, a është pjesë e reformës? Të gjitha këto duhen orientuar në debat, se nuk mund të vijë këtu të marrë mikrofonin edhe të kthehet pastaj në një arenë politike. S'mund ta lejmë këtë gjë. Në qoftë se doni, të merrni tamam mendime. Përndryshe, do mbahemi me krahë ne këtej, ne andej. Ne dihet si është balanca. Nuk ka lidhje fare, s'ka pse të hapim një debat tjetër politik, sepse kemi boll debate politike ku bëjmë në këshilla bashkiak, në parlament e ku di unë kudo, kudo që jemi. Kështu që do ishte, do ishte e mira që ta orientoni debatin me këto gjëra, të thoni si ka qenë në 2012, si është sot, se nuk është fare e vërtetë as ajo për Orikumin që ka thënë Banka Botërore. Nuk është fare e vërtetë që janë vetëm 40 milionë lekë investime në Delvinë. Të gjitha këto janë siç si na i merr mendja. Ne çohemi, marrim mikrofonin dhe themi: "Jo, më mirë aty zyrtare. Le ta verifikojnë të dy bashkëkryetarët, edhe të opozitës, edhe të mazhorancës, të dhënat që jepen nga institucionet ndërkombëtare, të certifikohen nga dy dhe të vijnë të paraqiten." Dhe pastaj të bëhet debati, se nuk mund të bëhet kështu. Unë po të dua ju flas gjithë ditën sot për shumë të mira që i ka bërë Shqipërisë kjo reformë, edhe për të meta, sigurisht që i ka pasur, sepse asnjë reformë nuk është perfekte. Dhe një gjë duhet ta dini: të gjitha vendet perëndimore që i kanë bërë këtë reformë e kanë shoqëruar me një pasreformë. Të gjitha: Irlanda, Suedia, Greqia, po të doni, meqë një pjesë e madhe keni qenë në Greqi, e kanë shoqëruar me një pasreformë pak a shumë tek 10-vjeçarja. Ka pasur edhe më shpejt, sepse konsolidohet edhe gjithë formatimi që bëhet me reformën e parë. Kështu që, prandaj, doja të ndërhyja. Nuk dua të them fare konsideratat e mia për reformën. Thjesht dua një sugjerim që ta orientojmë debatin për të marrë më të mirën nga debati. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Faleminderit, zoti Çuçi, për hir edhe të procesit. E vërteta është që në këtë fazë të parë, po, në këtë fazë të parë, komisioni ka vendosur të dëgjojë qytetarët, por edhe aktorët e angazhuar, dhe në një fazë të mëtejshme të hedhë për diskutim, të hedhë për diskutim alternative. Ju faleminderit. Ëh, për arsye, jo, okej, atëherë e mbyll zoti Dule.

Besmir Veli:

Besmir Veli, kryetar i bashkisë Delvinë, nuk kisha ndërmend në fakt të merrja fjalën, dhe sot ja lënim qytetarëve këtë gjë për të shprehur ata se çfarë, se çfarë ata kanë parë në këto vite dhe çfarë duan në të ardhmen për familjet e tyre dhe për fëmijët tanë që ne po i rrisim në, në, në këto, në këto bashki të cilat ne përfaqësojmë. Por u detyrova nga zonja Zhupa. Nuk e di nga e ka marrë këtë informacion që është në këshillin bashkiak që ju përmendi, apo anëtarët e këshillit të bashkisë, të forcës politike që ju përfaqësoni, pothuajse nuk marrin pjesë fare në ato mbledhjet e këshillit bashkiak. Ëh, dhe përmendi në fillim të fjalisë së saj: "Tani dëgjova me vëmendje të gjithë ata që folën dhe dua për respekt dhe ju të më dëgjoni për atë çfarë po çfarë dua të them." Dhe në fillim të fjalisë së saj e nisi me një reformë administrative ose territoriale të dështuar që nuk është aspak e vërtetë, sepse, sepse, po, po, sepse ne, ne, ne i kemi prekur ato fshatra apo ato njësi administrative edhe më përpara se ato të bashkoheshin me bashkinë e Delvinës, dhe sot kemi fshatra në njësi administrative të Vergojit e cila bën pjesë në bashkinë e Delvinës me reformën e 2014-s, të cilat po investohen, po investohen në rrugë të brendshme, po investohen në, në, në ndriçim rrugor që kur e ka pasur, kur e ka pasur këtë, këtë komunë, ë, partia e zonjës Zhupa nuk ka pasur as ndriçim në, në, në ato fshatra, dhe sot madje ata nuk kanë, nuk kanë mundur të bëjnë as rrugën e njësisë administrative. Këtë po e bën sot bashkia e Delvinës në mbështetje me Partinë Socialiste. Shumë faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, zoti Dule. Zoti Dule, dhe ë, e përmbyllim në fund me dy bashkëkryetarët. Faleminderit.

Ergest Dule:

Okej, vazhdon Dulja e Konispolit, se u bëmë lëmsh në zgjedhjet e Himarës. Ç'punë ka Dulja e Konispolit në zgjedhjet e Himarës? Jo, isha në plazh. Atëherë mirë do ishte që këto dy minuta t'i konsumoja aty në Konispol apo në Sarandë, dhe ju do të shikoni vërtetë dëgjuesë qytetarësh dhe jo dëgjuesë kryetari, kryetari i këshillit dhe tërë me tre katër veta që kemi limit ne që mund të sjelli nga Konispoli, nga Delvina apo nga kudo. Kjo do të ishte më e mira. Një nga ju ekspertët, një politikë PSPD, të ishit në Konispol dhe mund të bënim tre dëgjesa sot dhe tre nesër, dhe kështu që mbaronim punë me gjithë qarku. E para do të ishte kjo dhe do të merrnit dëgjesa e vërtetë qytetarësh që aty në Konispol, Sarandë apo Delvinë funksionon bashkia apo nuk funksionon. Në qoftë se këtu do të vijmë me tre veta dhe do të sjellim njerëz, dy do flasin mirë, një do flasin keq, dhe këtë e kam shprehur dhe te zoti Mazniku. Nuk u mor konsiderata. Atëherë vijmë ne këtu. Tani unë jam kryetar bashkie në Konispol dhe përfaqësoj një komunitet të tërë që merren me bujqësi, blegtori dhe pak agroturizëm. Kur them pak, pak, sepse janë iniciativat e para që kanë filluar. Po të krahasojmë me reformën e 2015-s, këtu mund të rri tërë ditën të flas, sepse kam qenë drejtori i financës i parë në 2015 në Konispol dhe kam bërë të gjithë përthithjen e bilanceve të ish-njësive, ish-komunave. Dhe këtu do t'ju them pastaj për të gjitha përfitimet që pushteti vendor, apo si të thuash, përfitimet në komunitet, pushteti vendor ka realizuar, që nga ndriçimi publik, që nga furnizimi me ujë, që nga arsimit, që nga shkollat, që nga kopshtet, që nga kanalet, që nga ujitja, nga

kullimi, nga vaditja dhe nga të gjitha këto funksione që pushteti vendor i ka sot. Dhe këtu padyshim që kemi ecur drejt pozitives. Ka vënë për më mirë, pa diskutim që ka vënë për më mirë, dhe këtë kërkon reforma aktuale. Pikërisht nga kjo je ministru, se duhet të bënë të mirën. Në qoftë se do jemi mirë, s'e kërkojmë as ju, as ne, as qytetarët, as asnjë. Por ku do shkojmë? A ja vlen që Konispoli, Delvina, Finiqi të shkrihen drejt një bashkie më të madhe? Këtë e vendosin treguesit, e vendosin dëgjuesat, e vendosin ato termat si pjesa krahinore, pjesa financiare, pjesa e aseteve njerëzore, aseteve publike që ne menaxhojmë, dhe jemi të aftë të krijojmë ekonomi, apo jo? Por mendimi im si kryetar bashkie, dhe jam e kam shprehur këtë, dhe për këtë kam marrë dhe kritika gjithandej, bashkitë janë ofruet shërbimesh, nuk janë njësi ekonomike që duhet të dalin me fitim në fund të vitit. Shërbimi pranë qytetarit është determinant. Bashkitë janë ende publike, nuk janë njësi rentabël fitimprurëse, ku di unë, me radhë. Në fund, bilanci i bashkive duhet të jetë i balancuar, sa të ardhura, sa dhe shpenzime. Bashkë me Valbonën kemi qenë në shumë dëgjesa, por një kritikë të vogël që këtu të gjithë foltorët i përmendim me emra, ne kryetarëve na di dhe mbiemri ndoshta na i ngatërroi për pak. Atëherë tek pjesën e minutazhit do ta kaloj, se jam i parafundit pas Dules tjetër. Çfarë kërkojmë ne si pushtet vendor? Është që funksionet e pushtetit vendor të jenë të mirëpërcaktuara dhe të mirëfinancuara. Nuk mundet që pushteti qendror të na delegojë ne digat dhe ku di unë, liqenet, dhe pas tre muajsh të na thotë si u bënë ato diga. Na i përshkruan në gjendje të amortizuar, dhe pas tre muajsh ta kërkon informacion në çfarë gjendje janë digat. Këtë nuk e pranojmë ne. Askush nga kolegët tanë, as tek asetet siç ishte fusha e kullimit dhe ujitjes, dhe funksionojnë me skema vjetore nga Ministria e Bujqësisë. Aplikojnë 61 bashki, marrin 26 sipas kritereve që duhet t'i dimë dhe s'duhet t'i dimë, por ama ky investim duhet të shkojë në atje ku ofrohet bujqësi, atje ku ofrohet turizëm, të shkojnë në Sarandë, Ksamil, s'jemi kundër. Funksionet duhen të jenë të mirëpërcaktuara dhe të mirëfinancuara. Pjesa me ujësjellësat, të gjithë e dimë kryetarët e bashkive që nuk ka ecur. Mund të jenë mirë financiarisht sot, por në aspektin e shërbimit ndaj qytetarit nuk janë mirë, dhe ky është shërbimi. Ofrohet, ujësjellësat janë shërbim. Konispoli ka qenë me humbje në aspektin e energjisë elektrike, sepse të gjitha i ka pasur me ngritje mekanike, por në aspektin e shërbimit ka 13 fshatra me 24 orë ujë këtu e 5-6 vjet përpara. Kështu që funksionet dhe kompetencat duhet të jenë të mirëpërcaktuara dhe të mirëfinancuara. Ju faleminderit, zoti. Një të fundit vetëm për bashkitë si kapacitete thithëse të fondeve të Bashkimit Evropian. Bashkia Filat është një bashki ngjitur mua, ka të njëjtin kapacitet, të njëjtin sipërfaqe, të njëjtin popullsi, dhe 15 milionë euro e ka buxheti i bashkisë Filat. 2. Pak e ka nga BE-ja, 1.5 i ka të ardhurat veta, dhe pjesën tjetër e ka investime nga pushteti qendror ose periferia që e quajnë ndryshe. Bashkitë kapacitete kanë, por të trajnohen, talgën prandaj e krijuam.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit, zoti Dule, dhe do t'ju kërkoj mirëkuptim për ta përmbyllur këtë takim. Përndryshe, bashkëkryetarët duhet ta vendosin.

Vangjel Dule:

Po, unë dëshiroj t'ju falenderoj. Mëngjes që e kërkoja fjalën në momentet e fundit. Më shkoi mendja në një sekondë kur Çuçi u tërhoq nga diskutimi, se do shfrytëzoja

miqësinë të mirë dhe kohën e tij. Po e e çoj debatin në pikën e nisjes, por nuk do tundohem. Do ta lë për një rast tjetër. Kemi një tendencë: fetishizojmë shifrat, statistikën. Thjesht do t'ju kujtoja thënien e një ekonomisti shumë të madh: "Mirëqenia e shifrave është mjerimi i qytetarëve." Kjo jeni gjithmonë parasysh këtë, dhe mos u nisni dhe përfundoni vetëm nga shifrat. Nëse në këtë sallë, pavarësisht këtyre opinionëve që dëgjuat, do të ishin ose do të kishin mundësinë të ishin ata ndaj të cilëve është bërë padrejtësia më e madhe nga kjo ndarje territoriale administrative, situata do ishte krejt ndryshe. Pse nuk ishin ata viktimat më të mëdha të kësaj ndarje territoriale? Sepse nuk kanë mundësinë objektive të kohës që të jenë të pranishëm në një tubim të tillë. Katër orë i duhet, për shembull, minimumi teologut ish-komunës së Dhivrit për të ardhur në qendrën e Vlorës, dhe po katër orë për t'u kthyer prapë në shtëpi. E kuptoni tmerrin që kemi krijuar me këtë ndarje territoriale administrative? E dyta, dëgjoni dhe shikoni qytetarët që kanë dëshirë për t'u shprehur. Ky është deficieti i përfaqësimit dhe i demokracisë, sepse asgjë nuk funksionon. Gjetën një rast në 12 vitet e fundit, që erdhi komisioni ad hoc i reformës territoriale për të shprehur mendimin e tyre. Kjo situatë është krijuar me këtë pushtet vendor, produkt i reformës së vitit '14, implementuar në zgjedhjet e vitit '15, dhe nga ana tjetër unë habitem se si kanë kurajon dhe dalin përpara qytetarëve, kryetarët e bashkive të cilëve kryeministri thotë: "Shko ti, ngrihu ti, ulu ti, dil përjasht, shkarko" nën kryetarët e bashkive dhe na flasin për kompetenca. Zotërinj, nuk keni kompetenca. Jeni mëkëmbësit e mbretit. Ky është realiteti i hidhur, dhe këtë e dinë të gjithë. Dhe e fundit që do doja të thosha: jemi, më falni, socialist të nderuar, nëse ju thirra mbretin, kërkoj ndjesë. E fundit që dëshiroj të theksoj është se në qarkun e Vlorës kemi një bashkëjetesë shembullore midis komuniteteve të ndryshme me karakteristika të ndryshme. Kemi minoritetin etnik grek për të cilin Këshilli i Europës, pas reformës së zotit Çuçi të vitit 2014, thotë se nuk janë marrë parasysh mendimet, opinionet, shqetësimet e minoritetit etnik grek në raportin e katërt, në raportin e pestë, respektivisht në vitin 2019 dhe në vitin 2023. Është momenti që kjo të merret parasysh. Nuk duhet të harrojmë se në të gjithë republikën sot që po flasim, regjistrimi i pronës është në mbi 60% regjistrim i dytë, regjistrimi në bashkinë e in marrës, regjistrimi i pronës në bashkinë e Finiqit, në bashkitë e Dropullit, mezi arrin 20-30%, dhe këto janë problemet dhe hallet që i ka krijuar dhe nuk i ka zgjidhur reforma e vitit 2014, dhe e kaloj për 10 sekonda zonjës Zhupa për një plotësim.

Valbona Karakaci:

Jo, jo, zonja Zhupa ka folur. Ina, të lutem, a mundem? Zoti Ina, do t'ju lutesha do të kërkoja mirëkuptim. Zoti Vaso, ju lutem,

Z. Vaso:

Faleminderit, zonja moderatore. Po ju them që fëmija lind tre kile, mund të vdesin 80. Bëmë një reformë në vitin 2014, jemi në vitin 2026. Nuk do të thotë që ajo reformë ishte e gabuar, por ishte shumë e saktë, shumë e mirë. Por që të përmirësohemi do të thotë që të ndërrojmë numrin e këpucës, zonja dhe zotërinj, për të cilët keni kurajon të thoni që gjithë salla ishte dakord që kjo është një reformë e dështuar. Nuk është ashtu. Secili të respektojë opinionet dhe mendimet e veta. Ne jemi këtu që të korrigjojmë reformat për të cilat vitet sjellin nevoja të tilla. Dhe që të jemi të qartë, duhet të zbatojmë atë çka thotë

Komuniteti Evropian, që të respektojmë Konventën e të Drejtave të Njeriut dhe mbi të gjitha Konventat e Minoriteteve për Bashkinë e Finiqit, dhe të respektohet që të jetë një bashki e veçantë, siç duhet të respektohet dhe për Bashkinë e Konispolit dhe të Delvinës dhe Sarandës, që janë bashki të cilat kanë specifikat e veta në krahasim me çdo lloj bashkie tjetër. Dhe e fundit që do të thosha ishte që do të doja dhe do të ishte më e saktë, siç e ngrita dhe në Komisionin e Reformës Territoriale, që dëgjesa të ishte bërë veç për zonën e Sarandës, për katër bashkitë e Sarandës dhe veç për bashkitë e Vlorës. Ju faleminderit.

Valbona Karakaci:

Ju faleminderit. Ju kërkoj, duke kërkuar mirëkuptimin e të gjithëve, dhe njëkohësisht duke ju kërkuar falje për të gjithë ato që nuk kanë mundur ta marrin fjalën, do ketë platforma dhe diskutime të tjera. Më lejoni t'ia kaloj fjalën dy bashkëkryetarëve.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Atëherë, ëh, të nderuar qytetarë, se ishte shumë e pritshme që në Vlorë do kishte emocione, pasione, debate, diskutime, dhe ishte ashtu siç dhe pritej, një debat me shumë dëshirë. Sigurisht kemi dhe këtë pjesën që, ëh, një pjesë e njerëzve do merresh me protokollin, se ke gjithë kohës që i flet njerëzve në fjalë. Të lutem, merr fjalën për të folur, merr fjalën për të folur kur e kishe për të folur, dhe të lutem shumë, të lutem shumë, sepse je i vetmi person në sallë që i flet çdo personi që flet, po çdo njeriu që flet. E vetmja, e minimumi, minimumi i bazik i etikës është që kur dikush flet, të lejmë, unë nuk i kam ndërprerë asnjë njeri. Kërkesa që kam është që të mos ndërprish njeri. Tani, ëh, u foli të folën të gjithë njerëzit dhe ta lejmë që të flasim me etikë çdo njeri. Të flasim fjalën e vetë. Tani, të kthehem në dy-tre konkluzione, se siç e thashë përpara, ëh, në situatën e Vlorës, kjo diskutim ishte i pritshëm. Sidoqoftë, është shumë dhe interesante fakti që, ëh, kemi një debat i cili është real, është një debat i cili i prek jetën e njerëzve, është një debat i cili i prek përditshmërinë në mënyrën si qeveriset vendi, është një debat i cili i prek, ëh, mënyrën si administrohet territori rreth nesh, por nga ana tjetër ky është një debat i cili ka kontradita dhe brenda nesh. Nga njëra anë, me të drejtë, kemi kryetarë qytetarë anëtarë të Këshillit Bashkiak që kërkojnë kompetenca, dhe shumë me të drejtë. Është shumë normale që njerëzit thonë: "Ne duam të kemi më shumë kompetenca këtu afër nesh." Vlora ka një barceletë të famshme me kompetentin, se shkojnë bashkë ajo kompetencat, kërkojnë dhe kompetentë, kërkojnë një person i cili dhe persona të cilët janë të aftë dhe të zotë ta zbatojnë kompetencën. U ngre një diskutim këtu për demokracinë, shumë i drejtë. Duhet ta çojmë vendimmarrjen afër njerëzve, dhe në fakt parimi i subsidiaritetit, i cili e përmendi dhe zoti Mala në fillim, i cili është parimi që thotë: "T'i çojmë shërbimet sa më afër njerëzve." Është një ndër parimet shumë të rëndësishme, jo vetëm për pushtetin vendor, është një parim shumë i rëndësishëm dhe mbi të cilin është ndërtuar Bashkimi Evropian, por neve harrojmë ose s'e themi me qëllim gjysmën e dytë të atij parimi, i cili thotë: "Ta çojmë shërbimin sa më afër njerëzve, ku është e mundur të ushtrohet shërbimi." Se nëse ne e çojmë shërbimin afër njerëzve dhe e themi që po, ky procesi do bëhet shumë afër njerëzve, po aty nuk ka arkitekt, nuk ka inxhinier, nuk ka punonjës social që ta ofrojë shërbimin, atëherë nuk kemi çuar shërbimin, kemi çuar një lugë bosh. Me të drejtë, kryetari ngriti një shqetësim

dhe një ankesë: "Kanë kaluar digat në emrat e bashkive." Pyetja është: "Kanë inxhinierë digash?" Se është një gjë të kesh digën dhe të kesh kompetencën për digën. Pyetja është: "A e ke personin përgjegjës që është inxhinier digash që di si mirëmbahet diga?" Dhe kompetencat vijnë bashkë me përgjegjësinë. Dhe pjesa e dytë me të cilën kompetencat vijnë, për të cilën neve prapë nuk folëm mjaftueshëm, për fat të keq, janë çështjet e financave vendore, dhe çështja e financave vendore është në dy kolona: njëra kolonë është financat që ngrihen vetë nga bashkitë, dhe pjesa e dytë ka të bëjë me financat të cilat vijnë nga granti qendror që qeveria ia alokon bashkive. Pjesë e diskutimit që ne nuk kemi folur është: "Sa kapacitet kanë bashkitë për të ngritur financave?" Sepse autonomia është shumë e rëndësishme, por autonomia është proporcionale me sasinë e parave që një komunitet i ngre vetë. Ne dhe në shtëpinë tonë, nëpër shtëpitë familjare, kemi zakon që i kemi thënë kalamajëve, djemve, i themi: "Kur të sjellësh rrogën, do kesh mundësi të flasësh më shumë për vendimmarrjen e shtëpisë." Dhe në qoftë se një njësi, një territor i caktuar, nuk ka kapacitet të ngrejë financa, është kollaj të kërkojë autonomi vendimmarrëse për fonde që s'i ka të vetat, që s'i ka ngritur vetë. Pa dyshim që këto shkojnë bashkë. Pra, dhe pyetja e debatit që bëjmë dhe është i shëndetshëm të bëjmë është: "Kush është ekuilibri midis autonomisë dhe mundësisë për të pasur më shumë financa dhe për të pasur të drejtë për t'i thënë këto gjëra?" Nga ana tjetër, u diskutua me shumë drejtë dhe për çështjen e shërbimeve. Dhe cilat shërbime mund të ofrohen më mirë pranë bashkive dhe sa pranë bashkive? Ka një debat që disa nga njerëzit u thanë që është e kemi larg, tha zoti Dule, një territor të caktuar. Pyetja e rëndësishme është që: "A duhet që qytetari të vijë në bashki për ta marrë shërbimin, apo mund ta marrë shërbimin aty ku është?" Jo, jo, dhe thelbi është që kryetar nuk i duhet qytetarit të vijë në bashki për planin urbanistik, nuk i duhet të vijë as për planin e strehimit, nuk i duhet të vijë as për planin e menaxhimit të mbetjeve. Për ato tema që diskutojmë, nuk i duhet të vijë qytetari te bashkia. I duhet bashkia të shkojë te qytetari. Si deputet me shumë eksperiencë, zoti Dule, ju dini shumë mirë që regjistrimi i tokave nuk është çështje e bashkisë, është çështje e hipotekës, dhe fakti që e ngrini çështjen në një debat që lidhet ngushtisht me funksionet vendore për një element i cili nuk është funksion vendor, në qoftë se juve do të kishit ardhur me propozimin dhe thoni: "Dëgjo, ky funksion sot as nuk ka qenë vendor, as nuk është vendor." Tani, a mund të bëhet vendor? Ky është debat që duhet ta ngreni. Po, në asnjë moment. Tani, dhe thelbi i reformës është pikërisht ky. Nga ana tjetër, elementi i fundit që dua të them që besoj se është me shumë vlerë, në situatën e decentralizimit, u përmend këtu dhe ranë dakord të gjithë palët: në 2014 janë deleguar 20 funksione të reja. Nuk jemi në një situatë në të cilën para reformës bashkitë kishin funksione dhe funksionet janë përqendruar. Jemi në një situatë komplet të kundërt. Bashkive i janë dhënë funksione dhe bashkitë tani janë duke u zgjeruar dhe duke u fuqizuar për të pasur mundësi t'i ushtrojnë siç duhet këto funksione. Dhe debati që ne kemi të bëjmë nuk ka të bëjë me sasinë e funksioneve që kanë bashkitë sot. Debati që kemi të bëjmë është me kapacitetet që bashkitë kanë për ta ushtruar siç duhet funksionin. Pyetja është: a e ushtrojnë dot strehimin social bashkitë? A e ushtrojnë dot shërbimin social bashkitë që e kanë funksion sot? A e ushtrojnë dot bashkitë çështjen e menaxhimit të ujërave të ndotura, e menaxhimit të emergjencave civile? Pra, shumë nga situatat që sot janë funksione të bashkiake, bashkitë nuk e kanë kapacitetin e burimeve

njerëzore, nuk kanë kapacitetin e burimeve financiare, nuk kanë targët e veta, dhe ky është padyshim një debat që bën sens të bëhet, dhe është një debat i cili ka argument të bëhet. Por ama që të themi që jemi në një situatë në të cilën kemi më pak funksione, argumenti i fundit që dua të them, dhe me këtë do ta mbyll shkurtimisht, është një argument i cili u tha disa herë këtu dhe i cili është pjesë e të pavërtetave politike që hidhen dhe pastaj bëhen dhe popullore. Çështja e lëvizjes së popullsisë nuk ka asnjë korrelacion, asnjë korrelacion midis lëvizjes së njerëzve nga zonat rurale drejt zonave urbane me ofrimin e shërbimeve apo me territorin. Fjala që bie, sepse numrat janë të rëndësishme, në Shqipëri në 2015 jetonin në zonat rurale 45% e popullsisë dhe 55% e njerëzve jetonin në zonat urbane. Ky numër sot është 59% ka shkuar në zonat urbane dhe 41% në zonat rurale, do të thotë ka një rënie me 4.4% nga zonat urbane drejt zonave rurale dhe ka një rritje me 4.0% në qytete. Në Zvicër, në të njëjtën periudhë kohore, në po këto 10 vjet, ka rënë nga 76 në 86 në qytet dhe nga 24 në 14, që do të thotë dhe në Zvicër njerëzit largohen nga zonat rurale drejt zonave të qytetarëve. Në Evropë është nga 76 në 74, në Kroaci që është më afër nesh është nga 58 në 55, në Suedi nga 86 ka shkuar në 89, që do të thotë lëvizja e njerëzve nga zonat rurale drejt zonave urbane është një fenomen global, është një fenomen i cili ndodh dhe në vende të zhvilluara dhe ndodh më shumë në vende që janë në zhvillim e sipër, dhe numrat e tregojnë këtë gjë. Dhe ne pastaj mund të rrimë dhe të flasim politikë sa duam, por ama e vërteta është që ka një trend global të lëvizjes së njerëzve i cili nuk lidhet me sa afër është bashkia, lidhet me faktin që me të drejtë edhe secili prej nesh këtu dhe një pjesë e madhe e njerëzve këtu kanë zgjedhur një moment të caktuar që të lëvizin nga një qytezë apo nga një fshat në një qytet më të madh, dhe kjo është një vendim që njerëzit e kanë bërë. E kemi pasur neve një sistem, zoti Dule, që nuk i lejonte njerëzit të lëviznin nga fshati në qytet, dhe atë e vendosëm ta hedhim atë sistemin dhe të dalim në një sistem në të cilin njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin të jetojnë ku duan dhe mos t'ia caktojë as qeveria, as politika ku do jetojnë. Dhe për sa kohë që njerëzit zgjedhin të bëjnë këtë lëvizje, ne kemi detyrë të axhustohemi me këtë lëvizje, jo të merremi me ndalimin e njerëzve dhe të themi: "Ti do jetosh këtu, sepse pasi shkova unë në qytet, tani unë do jem i fundit që do vij, ju vazhdoni të rrihi atje në fshat dhe merruni me bujqësi." Tani, dhe e fundit që është shumë e rëndësishme është që unë dëgjova me shumë respekt secilin prej njerëzve, pavarësisht mendimit që kam unë për. Dhe mendimet që thatë ju, dhe argumentet, dhe të vërtetat, dhe gjysmë të vërtetat, dhe nuk i fola askujt mbi fjalën e vet. Kjo gjëja e bërjes së zhurmës nga sfondi kur njerëzit flasin, sepse ju komentuat çfarë menduat ju të komentoj, unë komentoj atë që mendoj unë të komentoj, por ama baza normale e një komunikimi civil evropian është që në kohën e vet çdo person thotë mendimin e vet dhe pastaj personi në kohën e vet thotë të tjerët. Faleminderit shumë dhe ishte kënaqësi që patëm këtë bisedë.

Luciano Boci:

Po, faleminderit, meqenëse këtu u thanë shumë gjëra, u përplasën shumë mendime, dua dhe unë të ndërtoj atë parashtrimin tim. Në fakt, nga të gjitha këto është e vështirë ta përcaktosh kush është më e rëndësishme, por po e nis nga kjo: çështja e shpopullimit që qenka trend evropian dhe për këtë arsye ne kemi një ngjashmëri kaq të madhe me

Zvicrën, ndoshta me Gjermaninë, ndoshta nuk e di, llogariteni vetë me kë shtet mund të krahasohemi, por do thoja paksa në mënyrë popullore se argumentat ekzistojnë: në qoftë se njerëzit lëvizin në Zvicër, lëvizin nga e mira, ndërsa në Shqipëri lëvizin nga e keqja. Shpopullimi është një e keqe shumë e madhe dhe në fakt, në statistikat zyrtare, në ato renditjet botërore, Shqipëria konkurronte me Sirinë që ishte në luftë për humbjen e popullsisë për shkak të emigracionit, jo më të migrimit të brendshëm që humbjet janë drastike. Dhe në të gjitha studimet të organizatave ndërkombëtare dhe të organizatave jo ndërkombëtare, kombëtare, qartazi shpopullimi vjen për arsye të mungesës së shërbimeve në territore dhe zona të caktuara, për shkak të mospërfajësimit të territoreve dhe zonave të caktuara. Dhe vetë shteti nuk mund të rrijë duarkryq, pushteti vendor apo i qendror, përballë këtij fenomeni, por duhet të ndërhyjë, se u befasova nga pjesa tjetër: ne nuk mund të bëjmë asgjë, ne duhet t'i lëmë njerëzit të lëvizin. Nuk po themi që ne të nxjerrim ligje të veçanta siç kanë qenë dikur, që njerëzit ne t'i pengojmë, jo, ne duhet të bëjmë gjithçka që njerëzit të zhvillojnë terroret e tyre. Dhe unë, në fakt, e kam thënë në një vend tjetër, por po e them përsëri këtu, po e citoj më shumë në mënyrë perifrastike, sepse nuk e kam fjalë për fjalë, kur një miku im intelektual më thoshte që: "Shumë vëmendje për reformën territoriale, sepse ne po humbasim njerëz, duke humbur njerëz po humbasim territore, duke humbur terroret po humbasim toponimet, duke humbur toponimet po humbasim historinë, duke humbur historinë po humbasim kombin dhe po humbasim Shqipërinë, se pushtimet më të buta në botë nuk janë bërë me ushtri, keni gabim, janë pushtimet e buta me ardhjen e të tjerëve që plotësojnë boshllëqet e zonave tona. Ne duhet t'i zhvillojmë zonat tona dhe atëherë po të krahasohemi me Zvicrën. Kur të kemi të njëjtin nivel dhe standard ekonomik zhvillimi, në qoftë se ka lëvizje brenda migratore apo lëvizje të tjera, atëherë është dëshira e popullsisë. Ne në kushtet kur nuk ofrojmë asnjë shërbim dhe i kemi lënë ata në mëshirë të fatit, nuk mund të bëjmë krahasime të tilla se nuk mund të na e lejojë morali njerëzor dhe morali politik. Na i kurseni këto ironi, domethënë, sepse nuk janë të domosdoshme. Sikurse ju lutem shumë mos transmetoni këtu gjëra edhe që vijnë nga zyrtarë, gjëra qesharake, për afrim legjislativ me BE-në, me AKI-në. Nuk ka pushtet vendor AKI, nuk ka për afrim legjislativ, nuk ka kushte që duhet një legjislativ i tillë, sepse ne nuk e kemi që ne të futemi në Europë. Nuk ka kusht të tillë për pushtetin vendor. Ligji organik i pushtetit lokal i hartuar 2014-2015 është komplementar, ai përcakton, e tha kryetari i Bashkisë Konispoli, shumë funksione, por ai nuk përcaktoi mjetet, as mjetin financiar, as kompetencën dhe asgjë tjetër. Dhe këtu është e meta dhe përpos kësaj, atij ligji organik i janë kundërvënë një sërë ligjesh dalë nga pushteti qendror për urbanistikën. A doni ligjin për pyjet që po përgatitet që i merr kompetencat pushtetit vendor apo për ujësjellësat dhe VKM-ra që godasin kompetencat dhe funksionet e pushtetit vendor? Po, unë jam shumë dakord që ka bashki të cilat nuk mbulojnë të gjitha funksionet e tyre, se nuk kanë mundësi. Mos harroni një gjë që ekziston: bashkëveprimi, bashkëpunimi ndërbashkiak. Konispoli nuk mund ta ketë inxhinierin e digave, por mund t'ia marrë Sarandës. Ky është bashkëpunimi ndërbashkiak dhe nuk do të thotë që bashkitë duhet të jenë të barabarta në të gjitha kompetencat. Shumë kompetenca ose disa, se thashë shumë, disa kompetenca mund t'i marri niveli i dytë i qeverisjes, mund t'i marri qarku që nuk ka asnjë kompetencë dhe qarku të mbulojë ato funksione dhe kompetenca që nuk i kanë bashkitë

që quhen të vogla, por janë bashki funksionale. Këtu u vërtetua Konispoli, Finiqi, janë bashki të suksesshme, çka tregon që bashkitë e vogla lëvizin më mirë në terren, lëvizin më mirë në shërbime, po krijohen dhe të ardhura. Duhet dhe autonomi financiare, po duhet. Atëherë dalim tek legjislacioni europian, tek modeli europian. Propozimi jonë shumë i saktë: le të bëhet financimi për buxhetet e bashkive, qofshin këto të vogla, të mëdha, të mesme, 14% e Produktit të Përgjithshëm Bruto, aq sa ç'e ka Gjermania, dhe t'ia lejojmë bashkisë që t'i përdorë këto për investime dhe për çdo nevojë të vetën. U krijua dhe autonomia financiare, se deri tani kush e ka penguar këtë? Opozita paska penguar dhe zbatimin e funksioneve dhe të kompetencave dhe pjesën e autonomisë financiare? Opozita? Po këto janë gjëra që mund t'i bëjë vetë qeveria, mund t'i bënte, mund t'i propozonte, mund të ndërhynte, mund t'i ndryshonte. Edhe pse duhesh një reformë, një reformë territoriale duhet, sepse të gjitha konkluzimet dalin që bashkitë e mëdha nuk ofrojnë shërbime, janë jashtë funksionit të tyre, nuk mbulojnë dot gjithë territorin dhe shembulli tash më tipik është Vlora. Çfarë doni më shumë se keqmenaxhimi i fushës së mbetjeve? Çfarë doni më shumë që në Vlorë nuk funksionon ujësjellësi 24-orësh? Çfarë doni më shumë që orikumi nuk ka ujë? Se nuk është qog, zoti Çuçi, është studimi i Bankës Botërore, po desha t'jua citoj, por unë s'kam qejf të lexoj, t'jua citoj këtu, këtu si e thotë Qartazi, e përcakton: "Njësitë administrative që nuk mbulohen nga Bashkia e Vlorës është Orikumi, Shushica, Novosela dhe turizmi në Orikum konsiderohet në atë studim turizëm pompore" dhe jam habit nga neologjizmi, sepse uji vjen me pompë, vjen 1 deri në 2 orë. Pra, kjo është ajo që bashkitë e mëdha nuk e mbulojnë dot, i ka dalë territori nga kontrolli, nuk e pushtojnë dot gjithë territorin, aq më tepër që në territor nuk ka kontroll mbi territorin, sepse ndërtimet pa leje gëllojnë, vazhdojnë. Çfarë kontrolli ofrohet në një bashki të madhe? Nuk ofrohet dot dhe në qëndrimet tona ne jemi shumë të qartë dhe shumë të saktë, po duhet t'i rikthejmë funksionet të sanksionuara në ligjin organik, t'i rikthejmë po kompetencat, se janë mjet kryesor për realizimin e funksioneve, t'i rikthejmë autonominë financiare, të vendosim bashkëpunimin ndërbashkiak që zgjidh shumë probleme dhe patjetër që teza jonë është shumë e qartë edhe nga sa del nga konkluzionet, ne s'duhet të hezitojmë që të rrisim numrin e bashkive. Nuk është tabu, nuk është blasfemi kërkesa që vjen nga qytetari që ai të ketë bashkinë e vet sipas unitetit territorial edhe identitetit territorial, ekonomik, historik, kulturor, shpirtëror. Këtu u tha: "Konispoli është i tillë", po, patjetër, orikumi është i tillë, po, Amantja del e tillë, Ksamilli del i tillë dhe Mifoli del i tillë. Pse ne nuk duhet ta respektojmë këtë identitet ekonomik të tyre apo kur është historik dhe kulturor, pse duhet ta përziejmë? Sepse tek e fundit, ajo që unë në fakt e kam përdorur shpesh edhe këtu u përmend dhe nga një kryebashkiak, konkretisht i Konispolit, bashkitë, ju lutem shumë, nuk janë ndërmarrje fitimprurëse, janë ndërmarrje shërbyese dhe përfaqësuese, përfaqësim dhe shërbim. Taksat ne i paguajmë njësoj, të gjitha llojet e taksave, dikush e merr më pak shpërblimin e taksave tona, dikush e merr më shumë, dikush e merr më shumë se është bashki e madhe, dikush e merr më pak se është bashki e vogël, paguajmë njësoj për tarifa, për ndriçim, për mbetjet, për gjelbërim, por nuk i marrim shërbimet njësoj në të gjitha territoret ne. Është e vërtetë kjo? Hajde pra që të krijojmë kushtet që krahas shërbimeve të ketë edhe llogaridhënie. Kush jep llogari këtu nga kryetarët e bashkive sot si dikur ish-kryetari i njësie më të vogël vendore që sot është

zëvendësuar me një administrator pa asnjë kompetencë, pa asnjë buxhet dhe pa asgjë në dorë? Kush jep llogari? As përfaqësim, as llogaridhënie, as demokraci vendore dhe as shërbime me qytetarin dhe këto rikthehen dhe ne s'duhet të hezitojmë që bashkë mos bëjmë abstrakime, u dashën vetëm kompetenca, funksione dhe u kry puna. Po i kishit bërë më, i ka ligji, i keni vetë ligjet dhe kishte mbaruar. Jo, mo, jo, duhet dhe territori, mos e fshehim fare dhe ne themi që të shkojmë bashkë këtu, nuk po themi prevalon ky apo prevalon ai. Hajde të bëjmë një reformë siç kërkon vetë qytetari, t'i ngjajë peni i gzofit, e kemi ja ne nga zona jonë këtë, që t'i shërbejë totalisht atij qytetari. Çdo hezitim tjetër nuk na shërben, sepse ne këtë po kërkojmë dhe po doja shumë e hapur, kërkon jo për sfidë politike, rritjen e numrit të bashkive, për sfidë qytetare, kërkesë qytetare, kërkon dhe nivelin e dytë të qeverisjes, po, qarqet të marrin kompetenca që bashkitë mesatare apo të vogla nuk i realizojnë dot. 3 kompetenca themelore, 4 kompetenca dhe çdo gjë harmonizohet në një qeverisje vendore që shkon si shërbesë tek qytetari fundor dhe pastaj këto pjesët e rrugëve që s'do ndërtoheshin për 550 vite, këto janë çështje vullnetesh, çështje financash, mos, mos, financash, financash janë. Financash janë. Mirë se këtu u fol, jo, këtu u fol, u fol për edukatë, mos ndërhyrje dhe unë besoj që e dëgjuat bashkëkolegun tuaj dhe unë kam frikë, kryetarët e bashkive e kanë të gjithë autoritetin të vijnë pranë komisionit tonë, do shprehin opinionin e tyre në bazë të pyetjeve që do i bëjnë dhe anëtarët e komisionit, kështu që durim, unë mora një batutë, një qesim edhe një 550 vjet, kështu që më takon dhe unë bie shumë dakord me kërkesën e fundit, Valbona. Bie dakord me kërkesën që dëgjesat nuk duhet të jenë vetëm në nivel qarku, ne kemi kërkuar vazhdimisht të jenë të hapura dhe madje kemi bërë thirrje dhe duam që komunitetet e bashkive të caktuara të bëjnë kërkesë pranë komisionit tonë dhe ne jemi të gatshëm si komision të vijmë edhe në Konispol, edhe në Finiq, edhe në Sarandë, edhe në Cakran, edhe në Novosel dhe kudo në Shqipëri, por ama duhet një kërkesë nga ana juaj. Faleminderit.

Valbona Karakaci:

Duke i falënderuar veçanërisht qytetarët për pjesëmarrjen aktive dhe kërkuar ndjesë për hapësirën që ju la, ju lutem ndiqni kanalet e komunikimit në median sociale, në webin e parlamentit, do ketë një përmbledhje të këtij takimi, e cila është e aksesueshme për publikun. Ju informoj që ky takim u mbështet nga bashki të forta. Faleminderit.